rrjedhore	një lis-i	lis-it	disa lisa-ve	lisa-ve

RASA	LAKIMI I DYTË			
	njëjës		shumës	
	pashquar	shquar	Pashquar	shquar
emërore	një zog	zog -u	disa zogj	zogj -të
gjinore	i / e një zog -u	i / e zog -ut	i / e disa zogj-ve	i / e zogj -ve
dhanore	një zog -u	zog -ut	disa zogj -ve	zogj -ve
kallëzore	një zog	zog -un	disa zogj	zogj -të
rrjedhore	një zog -u	zog -ut	disa zogj -ve	zogj -ve

LAKIMI I TRETË

RASA	njëjës		shumës	
	pashquar	shquar	Pashquar	shquar
emërore	një pemë	pem -a	disa pemë	pemë-t
gjinore	i / e një pem -e	i / e pem -ës	i / e disa pemë -ve	i / e pemë -ve
dhanore	një pem -e	pem -ës	disa pemë -ve	pemë -ve
kallëzore	një pemë	pem -ën	disa pemë	pemë -t
rrjedhore	një pem -e	pem -ës	disa pemë -ve	pemë -ve

LAKIMI I KATËRT

RASA	njëjës	
	pashquar	shquar
emërore	një të ecur	të ecur -it
gjinore	i / e një të ecur -i	i / e të ecur -it
dhanore	një të ecur -i	të ecur -it
kallëzore	një të ecur	të ecur -it
rrjedhore	një të ecur -i	të ecur -it



lakimi i parë	lakimi i dytë	lakimi i tretë	lakimi i katërt
gjinia mashkullore		gj. femërore	gj. asnjëse
emrat me -i	emrat me -u	emrat me -a, -ja	emrat me -t, -të
plis -i, dash -i	plak -u, lëng -u	gom -a, lul -ja	të folurit, të ftohtët

MËSIMI 5



17. Lexoni tekstin "Lisi dhe lulja".

Në kopshtin e rrethuar me **lule** të bukura gjendet një lis i vjetër. **Lisi** qëndron aty me vite dhe Ammari sa herë kthehet prej shkollës së pari shkon ta përshëndes atë. Ai ka lidhur një miqësi të pashoq me **lisiin** e vjetër. Motra e tij e vogël Hafsa habitet me sjelljen dhe dashurinë e të vëllait që ka ndaj **lisit**. Një ditë i drejtohet atij:

- O vëllaçko, kopshti ynë është i qëndisur me **lule** shumëngjyrëshe. Ndërsa **lisi** yt është një ngjyrësh, i blertë e në anën tjetër është i vjetër dhe i trashë. Të lutem më thuaj çfarë gjen te ky **lis**,
- Pyeti e vogla Hafsa.
- Eja të tregoj moj **lulja** ime, a nuk ia sheh trungun sa të trashë e ka, shih degët e degëzuara që shkojnë aq lartë sikur prekin retë në qiell. Pastaj shikoja rrënjët sa të theksuara që i ka, ato aq shumë janë të lidhura me tokën sa është e pamundur t'i shkëputësh prej saj,
- Tha buzagaz Ammari.

1. Lexoni tekstin me vëmendje. Trego se për çfarë bëhet fjalë aty.

2. Gjeni emrat që janë të shkruar me ngjyrë të zezë.

18. Shkruani të gjitha format e gjetura në tekstin e sipërm të emrit lis.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

19. Lidhni me shigjetë emrin me rasën në të cilën është:

- | | |
|---------------------------------|----------------------------------|
| <input type="radio"/> Emërore | <input type="radio"/> lulen |
| <input type="radio"/> Gjinore | <input type="radio"/> lulja |
| <input type="radio"/> Dhanore | <input type="radio"/> prej lules |
| <input type="radio"/> Kallëzore | <input type="radio"/> i lules |
| <input type="radio"/> Rrjedhore | <input type="radio"/> lules |

20. Vendosni emrat në rasën e duhur.



Ajshja shkon në shkollë (shkolla) në orën (orë) 08.00. Shpjegimi (nxënës) ishte i qartë. Stina (vera) është e bukur. Loriku po shikon në televizor (film). Nëntori është muaji (festa) në Shqipëri. Kjo është (harta) e Turqisë. Këto janë (përralla) e Ezopit. Ajo aty është çanta (Burim).



21. Lakoni në trajtën e pashquar dhe në trajtën e shquar njëjës këta emra: fyell, oxhak, nënë, dele, shtëpi dhe të punuarit.

FYELL

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E.
Gj.
Dh.
K.
Rr.

OXHAK

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E.
Gj.
Dh.
K.
Rr.

NËNË

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E.
Gj.
Dh.
K.
Rr.

DELE

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E.
Gj.
Dh.
K.
Rr.

SHTËPI

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E.
Gj.
Dh.
K.
Rr.

TË PUNUARIT

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
E.
Gj.
Dh.
K.
Rr.



24. Detyrat

Handwriting practice area consisting of 20 horizontal wavy lines.

MĚSÍMÍ 5

Handwriting practice lines consisting of 20 horizontal wavy lines.

Handwriting practice lines consisting of 20 horizontal wavy lines.



Dinleme



Konuřma



Okuma



Yazma



FIGURAT LEGJENDARE



1. Dëgjoni dhe lexoni tekstin për Mustafa Kemal Atatürkun. Shënoni fjalët që i mësoni për herë të parë dhe gjeni kuptimet në fjalor.

Mustafa Kemal Atatürk

Mustafa Kemal Atatürku ka lindur më datën 19 maj 1881 në Selanik. Emri i babait ishte Ali Riza Efendiu dhe emri i nënës ishte Zonja Zybejde. Babai i vdiq kur ai ishte në një moshë të vogël.

Ataturku studimet e para i kreu në shkollën "Şemsi Efendi". Më vonë shkoi në "Selanik Askeri Rüstiyesi" dhe "Manastır Askeri İdadisi". Më datën 1899 shkoi në "Harbiye Mektebi". Ataturku është diplomuar në "Harp Akademisi". Ai ka qenë një oficer. Njëkohësisht ka qenë edhe themeluesi i Republikës së Turqisë dhe kryetari i parë i kësaj republike.

Më 3 mars 1924 Ataturku hoqi kalifatin. Ai veshi kapele për herë të parë më 23 gusht 1925. Ndryshoi alfabetin më 1 nëntor 1928. Ataturku ndryshoi sistemin e vjetër të ligjit më 17 shkurt 1926. Kuvendi i madh kombëtar turk i dha emrin Ataturk, Mustafa Kemalit më 24 nëntor 1928.

Ataturku vdiq më 10 nëntor 1938.



2. Përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit.



1. Ku ka lindur Ataturku?

.....

2. Si e kishte emrin nëna e Ataturkut?

.....

3. Si quhej babai i tij?

.....

4. Në cilën shkollë ka shkuar në fillim?

.....

5. Çfarë ka bërë në datën 23 gusht 1925?

.....

6. Kur e ka marrë emrin Ataturk?

.....

3.

Tregimi tek ushtrimi 1 është një tregim i shkurtër. Gjeni edhe ju të dhëna për jetën e Ataturkut dhe krijoni një tekst të ri.



Jeta e Mustafa Kemal Ataturkut

Handwriting practice lines consisting of a solid top line, a dotted middle line, and a solid bottom line, with vertical margin lines on both sides.

4.

Bisedoni në klasë për Ataturkun dhe më pas shkruani 5 gjëra nga karakteristika dhe 5 gjëra nga pamja e Ataturkut.



Five horizontal green sticky notes, each held by a red pushpin at the top center.



Five horizontal yellow sticky notes, each held by a red pushpin at the top center.

5. Mësoni disa thënie nga Ataturku.



Thëniet e Ataturkut

- Mësues! Gjenerata e re do të jetë përkushtimi juaj.
- Paqe në shtëpi, paqe në botë!
- Do të shkojnë ashtu siç kanë ardhur!
- Fshatari është i zoti i kombit!
- Mos kini frik të thoni të vërtetën!


Shtoni edhe disa thënie të tjera të Ataturkut:

-
-
-

6. Shkruani një biografi duke shfrytëzuar të dhënat në kronologji.



1879	←→	Lindi / 14 mars / Gjermani
1884	←→	Shkollën fillore / filloi
1894	←→	Filloi / jetoj / Itali
1896	←→	Filloi / punoi / politeknik federale
1901	←→	Shtetas / Zvicra
1902	←→	Vdiq / babai
1903	←→	Martesa
1922	←→	Çmim Nobel për fizik / fitoi
1955	←→	Vdiq



Biografia e Albert Einsteinit

Albert Einstein ka lindur më 14 mars në Gjermani.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

7. Lexoni në klasë biografite e disa figurave legjendare.



Steve Jobs ka lindur më 24 shkurt 1955. Ai ishte një biznesmen dhe investitor Amerikan. Ai ishte kryetari dhe bashkëthemeluesi i Apple. Steve Jobs në 5 tetor 2011 vdiq nga një sëmundje në Kaliforni. Pas vdekjes, ai është konsideruar nga shumë njerëz si "legjendar".



Stephen Hawking ka lindur më 8 janar 1942 në Shtetet e Bashkuara. Babai i tij quhej Frank Hawking dhe nëna quhej Isobel Hawking. Stephen filloi shkollën në "Byron House School". Stephen Hawking edhe pse në shkollë njihej si "Einstein", ai nuk ishte i suksesshëm që në fillim. Por më pas Hawking vendosi të studioi për fizik dhe kimi. Më 14 korrik 1965 Stephen u martua.

Stephen Hawking është një nga fizikanët teorik më të njohur në botë.




Thomas Edison lindi më 11 shkurt 1847 në Milan, Ohio (SHBA). Ai ishte fëmija i shtatë i familjes Edison. Nëna, Edisionin e ka shkolluar në shtëpi. Më pas Thomasi filloi të kishte probleme me dëgjimin. Për shkak të sëmundjes ai u detyrua të shpërngulej në një qytet tjetër i cili quhej Michigan. Ai atje shiste karamеле, gazeta dhe perime.

Thomas Edisioni ishte një shpikës, shkencëtar dhe biznesmen. Ai ka zhvilluar shumë pajisje që kanë ndikuar në jete në të gjithë botën.



Charlie Chaplin ka lindur më 16 prill 1889 në Londër. Gjatë jetës ai përjetoj shumë suksese në kinematografi. Charlie nuk dinte të lexonte dhe të shkruante por pasi që doli në një shfaqje u detyrua të mësoi leximin dhe shkrimin. Ai ishte një aktor, regjisor filmash. Charli vdiq në Zvicër më 25 dhjetor.

Në vitin 1917 Charlie Chaplin u quajt personi më i famshëm në botë.



Elvis Presley ka lindur më 8 janar 1935 në Mississippi, SHBA. Ai ishte një aktor dhe këngëtar me famë botërore. Karriera e tij muzikore filloi nga data 1954. Ai ishte një nga themeluesit e rokut. Kënga e parë e Elvisit e cila quhet "Heartbeat Hotel" u bë hiti numër 1 në SHBA. Elvisi fitoi titullin "Mbreti i Rok and Roll-it". Ai vdiq më 16 gusht 1977 në SHBA.

Ai konsiderohet si një nga figurat më të shquara të shekullit 20.



Ernest Hemingway ka lindur më 21 korrik 1899 në SHBA. Babai i tij ishte mjek dhe nëna ishte muzikante. Ernesti ka marrë pjesë në një numër boksesh sportive dhe futboll. Ernesti ishte një novelist Amerikan i famshëm. Ai ka fituar çmimin Nobel në Letërsi në vitin 1954 me veprën "Plaku dhe deti".

MËSIMI 6

8. Shënoni me "x" vendet e duhura sipas teksteve që keni lexuar. Shikoni shembullin e parë dhe vazhdoni si tek shembulli.



	Steve	Thomas	Elvis	Stephen	Charlie	Ernest
1. Është nga Amerika	x					
2. Është nga Shtete e Bashkuara						
3. Është nga Londra						
4. Është nga SHBA						
5. Është nga Mississippi						
6. Është nga Ohio						
7. Është novelist						
8. Është biznesmen						
9. Është këngëtar						
10. Është shpikës						
11. Është fizikanë						
12. Është aktor						
13. Ishte kryetari i Apple						
14. Ka fituar çmimin Nobel						
15. Ai nuk dinte të lexonte						
16. Ai njihet si "Einstein"						
17. Është quajtur "Mbreti i Rock and Rollit"						
18. Ai kishte probleme me dëgjimin						



9. Mësoni se çfarë janë përemrat.

Të mësojmë

Përemrat janë fjalë që zvendësojnë emrat. Ata janë si përfaqësues të tyre në fjali. Përemrat i ndajmë në 6 kategori.

1. Përemrat vetorë: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.
2. Përemrat dëftor
 - për afër: ky, kjo, këta, këto, i tillë, e tillë, të tillë, të tilla.
 - për larg: ai, ajo, ata, ato, i atillë, e atillë, të atillë, të atilla.
3. Përemrat lidhorë: që, i cili, e cila, të cilët, të cilat.
4. Përemrat të pacaktuar: dikush, ndokush, të gjithë, gjithçka etj.
5. Përemrat pronorë: im, ,me, yt, jote, i tij, e saj etj.
6. Përemrat pyetës: kush, cilli, ç', çfarë, sa, i sati, se.

Ushtrimi 1: Plotësoni vendet boshe me përemrat vetorë.

Unë dhe jemi shoqe të ngushta. dhe unë jemi në një klasë. nuk ndahemi kurrë. Njerëzit habiten me ne. ndonjëherë na shikojnë me xhelozë. Por jemi të gatshme për kaluar kohë edhe me

Ushtrimi 2: Gjeni dhe nënvizoni përemrat dëftor në fjalitë e dhëna të mëposhtme.

- Kjo shtëpi është e re.
- Ajo vajza është në klasën e tretë.
- Ai djali është 12 vjeç.
- Ato çantat janë të shtrenjta.
- Këta janë shokë të ngushtë.
- Ky pallati është i vjetër.

Ushtrimi 3: Në fjalitë e mëposhtme nënvizoni përemrat lidhorë që dini.

1. Mësuesja do i blej dhuratë vetëm atyre që do e kalojnë provimin.
2. Ana që u bë si flutur kur dëgjoji lajmin e mirë kërcëu nga gëzimi.
3. Dje takova një shoqe e cila më tha se moti do priset së shpejti.
4. Këngëtarja e cila unë e pëlqej shumë ka bërë një këngë të re.

Ushtrimi 4: Nënvizoni në tekst përemrat pronorë.

Në shkollën tonë secili prej nesh ka bankën e tij. Banka ime është pak më e madhe. Aty në bankë unë mbaj fletoren dhe lapsin tim. Ndonjëherë mbaj edhe çantën time. Edhe shokët mbajnë fletoret e tyre.

Ushtrimi 5: Krijoni disa fjali me përemrat pyetës.

1. Kush
2. Cili
3. Cila
4. Çfarë
5. Sa

10. Bashkoni figurat me fjalitë e duhura. Për ata që nuk i njihni shfrytëzoni internetin ose pyesni mësuesin/mësuesen.



Gazanfer Bilge



Naim Süleymanoğlu



Hülya Şenyurt



Muhammed Ali



Semih Sayginer

1. Sportist i cili ishte Kampion Olimpik botëror në peshëngritje. Ai u quajt "Herkuli i Xhepit" për shak të gjatësisë 147 m.

2. Lojtar i cili është kampion në bilardo.

3. Është një zhytëse e cila mban rekordin në dorë.

4. Është profesionist i motorëve, i cili fitoi numrin më të lartë të titujve të Kampionatit Botëror Supersport në 2007, 2010, 2012, 2015 dhe 2016.

5. Është profesioniste e lojës tenis e cila ka fituar shumë çmime për tenis. In.

6. Është një basketbollist profesionist i cili është me origjinë boshnjake.

7. Është lojtare e bedmintonit e cila luan me dorën e djathtë.

8. Ishte një boksier profesional amerikan i cili konsiderohet si një ndër boksierët më të mëdhejnë në kategorinë e rëndë.

9. Është një sportiste e cila fitoi medaljen e bronzit për femra në Judo (nën 48 kg) në Lojërat Olimpikë Verore të 1992.

10. Ishte një mundës i cili fitoi medaljen e artë në klasën të Mundjes së Lirë për Burra në Lojërat Olimpikë të vitit 1948.



Şahika Ercümen



Neslihan Yiğit



Kenan Sofuoğlu



Mirsad Türkcan



İpek Soylu



11. Detyrat

Handwriting practice area consisting of 20 horizontal wavy lines.

MĚSÍMÍ 6

A series of 20 horizontal wavy lines, spaced evenly down the page, intended for writing.

Handwriting practice lines consisting of 20 horizontal wavy lines.



Dinleme



Konuşma



Okuma



Yazma

MƏSİMİ

7



ÇFARƏ JETE!



1. Dëgjoni tekstin e mëposhtëm dhe më pas lexojeni në klasë.

Si e arrijnë njerëzit suksesin?

Të gjithë kanë një përcaktim të ndryshëm në jetë. Shumë prej nesh i kushtojmë shumë vlera performancës ose arritjes së qëllimeve të ndryshme. Të tjerët e lidhin suksesin me të mirat materiale, duke e matur atë me sa mund të fitojë dikush. Të tjerët matin suksesin sipas asaj se sa mund të kontribuojnë në familjen të tyre, ose në komunitetin dhe në shoqërinë në përgjithësi. Ka shumë përkufizime të tjera, por kryesisht sukcesi shoqërohet me pasurinë, me famën dhe me respektin. Megjithatë, nuk ka pse të jetë kështu.

Të jesh i suksesshëm mund të thotë të jesh i kënaqur me veten dhe karrierën tënde. Por si e arrin njeriu këtë ndjenjë të kënaqësisë me jetën dhe karrierën? Duket se njerëzit e suksesshëm vazhdimisht bëjnë dy gjëra:

- Ata përdorin aftësitë e tyre natyrore në punën e tyre.
- Ata vendosin qëllime për jetën dhe karrierën e tyre.

Me fjalë të tjera, njerëzit e suksesshëm zgjedhin karrierën ku mund të përdorin aftësitë e tyre natyrore. Për shembull, mësuesit e suksesshëm janë njerëz që instinktivisht dinë të ndihmojnë njerëzit të mësojnë, dhe mjekët më të mirë janë ata që dinë t'i dëgjojnë njerëzit. Njerëzit e suksesshëm e dinë se nga kanë filluar, dhe nga cili drejtim dëshirojnë ta vazhdojnë jetën dhe karrierën e tyre.

Cilat janë aftësitë tuaja natyrore? Cilat janë qëllimet tuaja në karrierë dhe në jetë? Nëse mund t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve, jeni në rrugën e drejtë për të pasur një karrierë dhe jetë të suksesshme.



MËSIMI 7

2. Përgjigjuni me disa fjali dhe me mendimet e juaja pyetjeve të mëposhtme sipas tekstit e ushtrimit 1.



1. Ekziston një mendim i përgjithshëm për përcaktimin e suksesit.

.....

2. Shumë njerëz mendojnë se janë të suksesshëm nëse janë të pasur dhe të famshëm.

.....

3. Njerëzit e suksesshëm zgjedhin karriera që përputhen me aftësitë e tyre.

.....

4. Bërja e asaj që ju vjen natyrshëm ju ndihmon të keni sukses.

.....

5. Çfarë është sukcesi sipas jush?

.....

.....

3. Zgjidhni një nga të dhënat e mëposhtme. Cila ju përshtatet juve? Bashkoni figurat me fjalët e dhëna.



1. Të marrësh një çmim.
2. Të marrësh rritje në rrogë.
3. Diplomimi.
4. Të fitosh një garë.
5. Të bësh një marrëveshje.
6. Të jesh i pasur.
7. Të jesh i famshëm.
8. Të kesh një punë.





4. Krijoni biseda në lidhje me suksesin duke përdorur fjalitë në ushtrimin 3.

Shembull:

A: Çfarë të bën të lumtur?

B: Mua më bën të lumtur një vend pune.

A: Përse?

B: Sepse unë mendoj se po të kisha një punë do fitoj para dhe do blej një shtëpi.

A: Por punën si do e marrësh?

B: Më duhet të studioj më shumë dhe të marr nota të mira.

-
.....
.....
.....
.....
.....
.....
-
.....
.....
.....
.....
.....
.....
-
.....
.....
.....
.....
.....
.....

5. Lexoni tekstet e mëposhtme pastaj bisedoni në klasë me shokët dhe shoqet.



Beethoven

Kur Beethoven ishte regjistruar në edukimin muzikor nga familja e tij për t'i bjerë violinës, mësuesi i tij i cili kaloi disa orë mësimi me të, nuk i pëlqeu bjerja e violinës dhe tha: "Ai nuk ka asnjë shpresë për t'u bërë muzikant".


Ai nuk u dorëzua dhe u bë një nga artistët më të vlefshëm në botë në artin e muzikës.



Tolstoi

Tolstoi, i cili arriti të bëhet një klasik në të gjithë botën me romanin e tij "Lufta dhe Paqja", nuk është ndryshe nga të tjerët. U përjashtua nga shkolla me vendimin e përbashkët të mësuesve duke u thënë " nuk ka dëshirë për të mësuar".

Por ai zuri vendin e tij midis shkrimtarëve të pavdekshëm jo vetëm në vendin e tij, por në të gjithë botën.



Pablo Picasso

I njohur si një nga artistët më të mirë në botë, Pablo Picasso nuk mësoi të lexojë ose të shkruajë derisa ishte 11 vjeç. Ai duhej të merrte mbështetje nga mësuesit e tij në mënyrë që të merrte një diplomë nga shkolla ku ai ndiqte arsimin e detyrueshëm.

Picasso, i cili u diagnostikua me një aftësi të kufizuar në të mësuar, u bë mjaft produktiv dhe i la njerëzimit mbi 20,000 vepra pasi filloi të pikturonte.

6. Shkruani mendimet tuaja në formë teksti sipas pyetjeve.



1. Çfarë kanë të përbashkët këta njerëz të famshëm?
2. Si mendoni ju? A janë këto histori suksesi?
3. Çfarë do të thotë suksesi sipas këtyre teksteve që keni lexuar?

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....


.....

.....



7. Mundohuni t'i gjeni se kush i ka thënë këto fjali të urta.

1. Jam më i dituri ndër të gjallët, se e di një gjë, e di se nuk di asgjë.
2. Nëse faktet nuk përputhen me teorinë, ndrysho faktet.
3. Ajo që nuk na vret, na bën më të fortë.
4. Paragjykimet janë ato që budallenjtë përdorin për arsye.
5. Një lider është një tregtar me shpresë.
6. Eksperienca është një mësuese e dashur dhe vetëm budallenjtë mësojnë nga gjëra të tjera.
7. Mund të zbulosh më shumë për atë person në një orë lojë se në një vit bisedash.
8. Miku i të gjithëve nuk është miku i askujt




Albert Ajnshtajn

.....



Benxhamin Franklîn

.....



Sokrati

.....



Platoni

.....



Aristoteli

.....



Friedrich Nietzsche

.....



Volteri

.....



Napoleon Bonaparte

.....

8. **Lexoni dhe plotësoni tekstin më poshtë me fjalitë e dhëna. Pastaj dëgjoni tekstin.**



1. Secili duhet ta gjejë vetë mënyrën më të mirë për të mos e humbur interesimin për çështjet e mëdha që kanë lidhje me fatin e njeriut dhe zhvillimin e shoqërisë.
2. Këtë luks mund t'ia lejojë vetvetes edhe më i varfri njeri, mjafton të ketë pak zgjim dhe vullnet.
3. Ajo është zana hyjnore që i jep kuptimin lirisë.
4. Vetëm se interesimi për të tilla çështje lyp një farë modestie.

KULTURA

Kultura është thesari më i çmuar i njeriut; ajo është stolia e mendjes, lartësimi i shpirtit, shkathhtësia e ndjenjave, freskia e shpirtit... Por kultivimi i vetvetes nuk është një send që mësohet në shkollë.
 Kulturën duhet ta kundrojmë si një mjet për të lartësuar veten nga pikëpamja intelektuale e morale, ashtu edhe për tu bërë sa më i vlefshëm i shoqërisë. Kultura është kondita e domosdoshme e çdo përparimi të vërtet të personit në lidhje me personalitetin.

Njeri me kulturë nuk është vetëm ai që interesohet për literaturë, për muzikë, për tablo e skalitje të stërholluar. Kultura e vërtetë na çel rrugën e së vërtetës. Në vend që t'i shuajë energjinë, kultura i ngjall njeriut në shpirt pasionet më të zjarrta. Përmes kulturës ne çmojmë vlerën e mendjes që është e para nga vlerat shpirtërore, shohim se nëpër çfarë kallëpe kalon e vërteta për të triumfuar, stërvitemi të urrejmë gënjeshtërën e falsitetin ndër të gjitha petkat që i vesh moda e ditës. Nuk duhen shumë të ardhura për t'u bërë njeri me kulturë.
 Sepse nuk është nevoja të mplakesh nëpër bibliotekat e muzetë. Mjafton të shikosh rreth e rrotull, të vëzhgosh, të krahasosh, të vrasësh mendjen për të kuptuar si është ndërtuar kjo gjë, pse punon kjo makinë, e të tjera.
 Prandaj kultura e vërtet duhet të jetë modeste, mbasi ajo nënkupton që çdo njeri për veten e tij të ndjejë nevojën për të ditur gjithçka kanë vepruar dhe kanë menduar të gjithë njerëzit e tjerë.

Tajar Zavalani (1903-1966)



9. Lexoni përsëri tekstin dhe zgjidhni se cila nga fjalitë e mëposhtme mund të jetë tema kryesore e tekstit.

- a. Ju bëheni të kulturuar nëse fitoni shumë para.
- b. Kultura gjithmonë njeriun e çon te rruga e vërtetës.
- c. Për të qenë i kulturuar duhet të jesh shumë i mençur.

10. Shkruani edhe ju një tekst me disa fjali në lidhje me kulturën. Mundohuni të shkruani disa këshilla.



Handwriting practice lines consisting of ten horizontal rows. Each row is bounded by a solid top line and a solid bottom line, with a wavy red line in the middle to guide letter height.

11. Bashkoni fjalët e nënvizuara me kuptimet e ngjashme të tyre.



a) punëtor

b) realizojnë

c) me aftësi

ç) fat

1. Ju mund të arrini ëndrrat tuaja kur të kenë besim.
2. Sokrati ishte një nga njerëzit e talentuar në të kaluarën.
3. Suksesi nuk është rastësi.
4. Ai ishte një student i zellshëm gjatë viteve të shkollës.



Jeta Në Të Kaluarën Dhe Jeta e Sotme

Nuk ka dyshim se gjërat kanë ndryshuar shumë midis së kaluarës dhe së tashmes në shumë aspekte të jetës, dhe ky ndryshim ka shkaktuar zhvillimin e civilizimit njerëzor dhe ndryshimin e formave dhe modeleve të jetës. Disa njerëz e shohin këtë ndryshim si pozitiv, disa argumentojnë se është e nevojshme të kthehen në vlerat e shoqërisë dhe zakonet e saj që mungojnë shumë në jetën bashkëkohore.

Ekzistojnë dallime shumë të qarta midis jetës së kaluar dhe asaj të tanishme.

Nga ana teknologjike mund të themi se jeta në kohët e vjetra kishte mungesa të mjeteve të teknologjisë që të cilat njeriu i ka në kohët e sotme. Prandaj në ato kohë njerëzit e kishin jetën e vështirë. Për shembull gjatë udhëtimit, njerëzit udhëtonin nga një vend në tjetrin duke përdorur deve ose në shtëpi përdorën mjete të thjeshta primitive për të përgatitur ushqimin. Ndërsa sot në shtëpitë e njerëzve ju gjeni shumicën e mjeteve që e bëjnë më të lehtë për njerëzit të jetojnë dhe të largohen nga vështirësitë dhe lodhja, të shkurtojnë kohën, përpjekjen dhe paratë. Dhe ata nga një vend në tjetrin shkojnë për një kohë të shkurtër.

Edhe komunikimi ka qenë shumë vështirë në kohët e vjetra. Ndërsa në ditët e sotme njerëzit kanë një teknologji të përparuar dhe komunikimi midis njerëzve kryet brenda disa sekondash.

Përveç këtyre duhet ta pranojmë se edhe traditat dhe zakonet kanë ndryshuar. Në të kaluarën, shoqëritë mund të mbyllnin veten dhe të ruanin trashëgiminë e tyre sociale dhe kulturore. Ndërsa sot nuk ka distancë midis jetesës të njerëzve. Domethënë ka ndryshime dhe pozitive por edhe negative midis së kaluarës dhe të sotmes.





13. Përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit të ushtrimit 12.

1. Çfarë teme ka teksti?

o

2. A janë pozitive apo negative ndryshimet midis të kaluarës dhe të sotmes?

o

3. Tregoni disa ndryshime edhe ju të cilat nuk janë përmendur në tekst.

o

.....

.....

.....

.....

14. Shkruani një tekst në lidhje me lojërat e fëmijëve në kohërat e vjetra dhe lojërat në ditët e sotme.



.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

MĚSÍMÍ 7

15.

Detyrat.



A series of 20 horizontal wavy lines for handwriting practice, spanning the width of the page.

A series of 20 horizontal wavy lines, spaced evenly down the page, intended for handwriting practice. The lines are light blue and have a consistent, gentle wave pattern.



Dinleme



Konuşma



Okuma



Yazma

MËSIMI

8




MËSONI NGA DJE DHE JETONI PËR SOT

1. Dëgjoni tekstin "Vizatuesja e vogël".

VIZATUESJA E VOGËL

- Nënë, më dhe fletët dhe lapsat, por ... nuk di ç'të vizatojë?!
 - Po ja... Vizato zogun.
 - Zogun? Mirë... E vizatova. Po tani?
 - Vizato macen.
 - Mirë... A të pëlqen?
 - Shumë.
 - Po tani?
 - Vizato... vizato... ujkun.
 - Po më del i keq, i egër...
 - Mos u mërzitë, i tillë është... Po mjaft! Bjer e fli!
 - Ah, jo! Tani m'i sill gërshtët.
 - Gërshtët?! Pse!
 - Ta ndajmë secilin veç e veç. Nata është e gjatë. Nuk ia kam besën as maces për zogun, as ujkut për qengjin...
 - Mirë. Ndaji dhe bjer e fli.
 - Është herët, nënë. Dua të vizatoj dhe pak.
 - Po ç'do të vizatosh ende?
 - Një çerdhe për zogun... Një copë livadh për qengjin...
- Pas pak vogëlushja u mbështet mbi fletën e vizatimit. Nëna e shtriu ngadalë në shtrat.

Arif DEMOLLI




6. Lexoni tekstin "Një histori e bukur".



Kur fillova klasën e parë unë nuk dija të vizatoja. Të gjithë shokët e shoqet e klasës i tregonin mësueses vizatimin me shumë mburrje. Unë si çdoherë e pikturoja me lot vizatimin. Një ditë mu afrua shoku im Deoni dhe filloi të më mësojë të vizatoj. Që nga ajo ditë unë mësova të vizatoj shumë bukur. Sot vizatimet e mia gjenden nëpër ekspozita të ndryshme nëpër botë. Po ashtu kam marrë shumë çmime të ndryshme. Çmimi i fundit që e mora ishte "Piktorja më e mirë e vitit".

7. Tregoni një histori të bukur me anë të vizatimit.



MËSIMI 8

8. Shkruani një ese me temën "Mësoni nga dje dhe jetoni për sot" lidhur me një përvojë personale që keni përjetuar në klasë / shkollë.



Handwriting practice area for question 8, consisting of 12 horizontal wavy lines.

9. Shkëmbeni përvojat me shokun / shoqen e bankës me temën "çfarë më mësoi jeta dje që sot dua ta jetoj këtë ...". Shkruaj përvojën më interesante të shokut / shoqes suaj poshtë.



Handwriting practice area for question 9, consisting of 12 horizontal dotted lines between two vertical pink lines.

10. Mësoni ndajfoljet e kohës.

Duhet të dimë: Ndajfolja e kohës emërton një rrethanë kohore, pra, emërton kohën kur kryhet a zgjat veprimi i shprehur nga një folje. Ndajfoljet e kohës janë: sot, dje, nesër, së shpejti, motmot, vit për vit, asnjëherë etj. Psh.: Dje erdhi Nora te ne për t'i bërë detyrat ndërsa sot ne do shkojmë tek ajo.

Ndajfoljet e kohës mund të tregojnë:

a) Kohë të saktë të kryerjes së një veprimi, si: sot, sonte, dje, nesër, pardje, tani, vjet etj.

Tani duhet të shkojmë se **nesër** do të bëhet vonë.

b) Kohë të papërcaktuar me saktësi, si: dikur, njëherë, një ditë prej ditësh, së shpejti etj.

Një ditë prej ditësh e vërteta do të dalë në shesh.

c) Kohë të zgjatjes së një veprimi, pra përforcimin e përsëritjen rregullisht të një veprimi, si: gjatë, gjithmonë, gjithnjë, kurdoherë, përditë, rrallë, shpesh, kohë pas kohe etj.

Xhaxha Tomorri **gjithnjë** mendon se ka të drejtë.

ç) Një veprim të çastit, si: aty për aty, menjëherë, njëherë, përnjëherë etj.

Na tregoi edhe arsyen **aty për aty** se përse i duhet të ngrihet e të shkonte në shtëpi.

d) Sasi të kohës për kryerjen e një veprimi, si: motmot, një copë herë, një çikë etj.

Elvana e piu edhe **një çikë** qumështin e ngelur në gotë.

11. Plotësoni vendet boshe me ndajfoljet e kohës: sonte, vjet, së shpejti, rrallë dhe menjëherë.

- Olisa do të vijë menjëherë të marrë me makinë.
- Retë mbuluan qiellin do të fillojë të bije shi.
- më merr malli për akullore gjatë stinës së dimrit.
- në orën 20.00 fillon shfaqja e përgatitur nga klasa jonë.
- Dielli dhe Mirëjeta filluan një projekt lidhur me rregullimin e parqeve të qytetit.


12. Me ndajfoljet e dhëna formo fjali: sot, pardje, gjithmonë dhe motmot.

- a.
- b.
- c.
- d.

MËSIMI 8

13. Mësoni kohët e shkuara të dëftores.

Libër



14. Mësoni zgjedhimin e foljeve të kohës së shkuar të dëftores.

Libër

E shkuar				
E pakryer	E kryer e thjeshtë	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejshkuar
Unë mësoja	mësova	kam mësuar	kisha mësuar	pata mësuar
Ti mësoje	mësove	ke mësuar	kishe mësuar	pate mësuar
Ai/ajo mësonte	mësoi	ka mësuar	kishte mësuar	pati mësuar
Ne mësonim	mësuam	kemi mësuar	kishim mësuar	patëm mësuar
Ju mësonit	mësuat	keni mësuar	kishit mësuar	patët mësuar
Ata/ato mësonin	mësuan	kanë mësuar	kishin mësuar	patën mësuar

15. Lexoni fjalitë e dhëna dhe nënvizo foljet duke treguar se folja përkatëse cilës kohë i takon:

1. Unë mësoja vjershën.

Koha e pakryer

2. Falë teje mësova.

3. Në korin e shkollës kam kënduar.

4. E kisha mësuar notin për pushime në det.

5. Dje pata mësuar tërë ditën.

16. Plotësoni vendet boshe me foljet e dhëna: punoja, punoje, punonte, punonim, punonit dhe punonin.

1. Ne punonim natë e ditë për të ndërtuar këtë kala.

2. Rrezearta dhe Samiu në Akademinë e Arteve të Bukura të Tiranës.

3. Ti me motrën time në të njëjtën fabrikë.

4. Unë me shumë zell qilimin e kuq.

5. Ti dhe Nisa nga dy orë në javë.

6. Asili aq shumë sa harronte të pinte ujë.

17. Zgjedhoni foljen shikoj në kohën e kryer të thjeshtë.

- Unë shikova një film në kinema.
- Ne një film në kinema.
- Ti një film në kinema.
- Ju një film në kinema.
- Ai një film në kinema.
- Ata një film në kinema.

18. Formoni fjali me foljet: luaj, shkruaj, dëgjoj, fluturoj, lexoj dhe filloj në kohën e kryer të dëftores.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

19. Foljet në kllapa nga koha më se e kryer ktheni në kohën e tejshkuar.

Ngrica (kishte filluar) pati filluar të zbutej dhe çdo ditë që kalonte, të afronte me pranverën. (Kishte filluar) koha unë dhe Bleroni (kishim ngritur) balonat. Pastaj (kishe hyrë) në stinën e verës dhe mund të shkoje të laheshe. Unë (kisha parë) kalendarin dhe kisha kuptuar se sa larg ndodhet vera! As ju nuk e (kishit kuptuar) përse jemi të shqetësuar.

20. Vendosni grupet e poshtme në kohën e kërkuar duke ruajtur vetën dhe numrin.

- shkojmë në shkollë * (në kohën e pakryer) ◦ (Ne) shkonim në shkollë.
- blej një triko * (në më se të kryerën) ◦
- shikojnë një film * (në kohën e kryer të thjeshtë) ◦
- këndon bukur * (në kohën e kryer) ◦
- shkruan një letër * (në kohën e kryer të tejshkuar) ◦

21. Gjeni foljet dhe tregoni se në ç'kohë, vetë e numër janë.

Mona vendosi (K. Th.; V. 3; Nj.) mbi supë rripat e çantës së shpinës. Ajo kërkoi me sy librin. Arlindi pati marrë librin atë ditë në bibliotekë. Olti jetonte në fshat. Fshati i kishte shtëpitë e shpërndara. Babai im kishte qenë gjithnjë një baba zemërgjerë. Në atë kohë pata qenë e re, e bukur dhe e shëndetshme. Sytë e saj të mëdhenj e të zinj merrnin një pamje të turbullt.

MËSIMI 8

22. Plotësoni tabelën me foljen lexoj, duke e zgjedhur foljen nëpër veta sipas kohës përkatëse.

E shkuar				
E pakryer	E kryer e thjeshtë	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejkshuar
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____

23. Mësoni zgjedhimin e foljeve "kam" dhe "jam" në kohën e shkuar të dëftores.

a. kam

E shkuar				
E pakryer	E kryer e thjeshtë	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejkshuar
Unë kisha	pata	kam pasur	kisha pasur	pata pasur
Ti kishe	pate	ke pasur	kishe pasur	pate pasur
Ai/ajo kishte	pati	ka pasur	kishte pasur	pati pasur
Ne kishim	patëm	kemi pasur	kishim pasur	patëm pasur
Ju kishit	patët	keni pasur	kishit pasur	patët pasur
Ata/ato kishin	patën	kanë pasur	kishin pasur	patën pasur

b. jam

E shkuar				
E pakryer	E kryer e thjeshtë	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejkshuar
Unë isha	pata	kam pasur	kisha pasur	pata pasur
Ti ishe	pate	ke pasur	kishe pasur	pate pasur
Ai/ajo ishte	pati	ka pasur	kishte pasur	pati pasur
Ne ishim	patëm	kemi pasur	kishim pasur	patëm pasur
Ju ishit	patët	keni pasur	kishit pasur	patët pasur
Ata/ato kishin	patën	kanë pasur	kishin pasur	patën pasur

24. Tregoni një tregim të bukur duke përdorur kohët e shkuara të dëftores para shokëve / shoqeve të klasës.



25. Shkruani me pak fjalë tregimin e rrëfyer para shokëve e shoqeve të klasës.



.....

.....

.....

.....

.....

.....

26. Dëgjoni disa fjalë të urta shqipe të shkruara nga shkrimtari Naim Frashëri.



Mos e lër punën për pastaj,
çdo punë ka kohën e saj.

Kohën e kurse, se ikën e s'vjen,
shkon e më s'e gjen. Me punë e
fiton, pa punë dëm shkon.

Sa do të rrosh,
do të mësosh.

MĚSÍMÍ 8

27. Detyrat.



A series of 20 horizontal wavy lines for handwriting practice, spanning the width of the page.

A series of 20 horizontal wavy lines, spaced evenly down the page, intended for handwriting practice. The lines are a light teal color and have a consistent, gentle wave pattern.



Dinleme



Konuşma



Okuma



Yazma

MƏSİMİ

9



FAKTE NGA BOTA



1. Lexoni tekstin me vëmendje dhe mundohuni ta kuptoni tekstin.



Fakte interesante në lidhje me gjumin

Njerëzit kalojnë një të tretën e jetës së tyre në gjumë! Gjumi i natës është i rëndësishëm për shëndetin e mirë. Sidoqoftë, njerëzit kanë nevojë për sasi të ndryshme të gjumit në periudha të ndryshme të jetës së tyre. Foshnjat kalojnë pjesën më të madhe të kohës në gjumë. Ata flenë deri në 16 orë në ditë. Ata rriten shumë në vitet e tyre të para dhe gjumi ndihmon që truri i tyre të zhvillohet.

Fëmijët midis 3 dhe 16 vjeç kanë nevojë për 10 orë gjumë, sepse ata gjithashtu rriten dhe mësojnë gjatë gjithë kohës. Ndërsa të rriturit zakonisht flenë rreth 8 ore gjumë. Por nëse ata nuk e bëjnë gjumin të mjaftueshëm atëherë detyrat e ditës duken më të vështira ose mund të kenë dhimbje koke gjatë ditës.

Por në botë ka dhe njerëz të çuditshëm që flenë pak orë gjumë dhe ky orar atyre i mjafton.

2. Përgjigjuni pyetjeve me "e drejtë" ose "gabim".



E DREJTË (D) / GABIM (G)

1. Ne e kalojmë gjysmën e jetës tonë duke fjetur.
2. Gjumi është shumë i mirë për shëndetin tonë.
3. Foshnjat flenë deri në 18 orë në ditë.
4. Gjumi ndihmon që thonjtë e foshnjave të rriten.
5. Të rriturve u duhen tetë orë gjumë në ditë.
6. Ne kemi dhimbje koke kur bëjmë pak gjumë.
7. Disa njerëz kanë nevojë për shumë pak gjumë.

MËSIMI 9

3. Dëgjoni me vëmendje dhe mësoni disa fakte interesante dhe për të qeshur.



A e dini se;

- Është e pamundur të lëpini bërrylin tuaj.
- Zemra e karkalecit është në kokën e tij.
- Njerëzit thonë "Shëndet!" kur teshtini sepse kur teshtini, zemra juaj ndalet për një sekondë.
- Zemra e një balene të kaltër është aq e madhe sa që njeriu mund të notojë nëpër arteriet e saj.
- Një oktapod ka tre zemra.
- Ka më shumë yje në qiell sesa kokrra rëre në botë.
- Mjalti është i vetmi ushqim që nuk priset.
- Muskuli më i fortë në trupin e njeriut është gjuha.
- Nëse loti i parë del nga syri i majtë tregon dhembje, nëse del nga i djathti tregon lumturi.
- Truri juaj është më krijimtar kur është i lodhur.
- Truri juaj përdor deri 20% të oksigjenit tonë dhe kalorive për të funksionuar.
- Njerëzit prodhojnë pështymë të mjaftueshme për të mbushur dy pishina me madhësi olimpike.
- Bebet shohin vetëm bardh e zi kur lindin.
- Minjtë dhe kuajt nuk mund të vjellin.
- Nëse i mbani një orë kufjet në veshë atëherë bakteret në vesh rriten 700 herë më shumë.
- Prej të gjitha krijesave në Tokë, vetëm njerëzit paguajnë para për të jetuar.
- Bletët vdesin pasi t'i sulmojnë njerëzit.
- Gratë hanë përafërsisht dy kilogramë buzëkuq gjatë jetës së tyre.
- Ashtu si njerëzit, macet mund të jenë majtake dhe djathtake.
- Kur pemët janë në gjumë të thellë, degët e tyre bien.

4. Gjeni disa fakte të tjera rreth botës dhe i shkruani. Pastaj shkruani mendimet tuaja se çfarë mendoni për faktet e ushtrimit 2.



.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



5. Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit.

Të vërtetat rreth frutave

- Ka mbi 1.000 lloje të ndryshme mollësh dhe thuhet se e kanë origjinën nga Kazakistani.
- Luleshtrydhet janë frutat e vetme në botë që farat i kanë nga jashtë dhe ato kanë të bëjnë me familjen e trëndafilave.
- Ekzistojnë mbi 100 lloje të ndryshme të bananeve dhe jo të gjitha janë të verdha. Disa nga ato janë të kuqe.
- Ullinj të në të vërtet janë fruta dhe pema e ullinjve mund të jetojë deri në 1500 vjet.
- A e dini se limonët përmbajnë më shumë sheqer sesa luleshtrydhet?
- Patëllxhanët në të vërtetë janë fruta.
- Mango njihet si "Mbreti i Frutave" në pjesën më të madhe të botës.



MËSIMI 9

Pyetjet:



1. Sa lloje të mollëve ka?

o

.....

2. Cila frutë i ka farat nga jashtë?

o

.....

3. Çfarë ngjyre tjetër mund të kenë bananet?

o

.....

4. Cila frutë ka më shumë sheqer sesa luleshtrydhet?

o

.....

5. Ulliri është frutë apo perime?

o

.....

6. Patëllxhanët në cilin kategori janë? Fruta apo perime?

o

.....

7. Cilat nga frutat janë më të shëndetshme sipas jush?

o

.....

8. A mund të shkruash edhe ti disa fakte interesante në lidhje me frutat të cilat nuk janë në tekst?

o

.....

9. A duhet ti konsumojmë të gjitha frutat? Si mendon ti?

o

.....

10. Cili është fruta e juaj e preferuar? Shkruaj diçka interesante në lidhje me frutën e preferuar.

o

.....



6. Lexoni disa fakte në lidhje me kafshët dhe mundohuni të gjeni se për cilën kafshë bëhet fjalë.

1. Cila kafshë tund bishtin dhe vrapon pas një shkopi?
2. Cila kafshë ka mustaqe dhe kap minj?
3. Cila kafshë hingëllon?
4. Cila kafshë mendohet të jetë mbreti i pyjeve?
5. Për cilën kafshë thuhet se është kokëfortë?
6. Cila kafshë ka një hundë të gjatë?
7. Cila kafshë mund të imitojë zërat e njerëzve?
8. Cila kafshë është emblema e paqes?
9. Cila kafshë helmon dhe nganjëherë shtrydh deri në vdekje?
10. Cila kafshë ha mjaltë dhe është një lodër e butë për fëmijët?
11. Cila nuk jeton në dritë?



Gjarpër



Ari



Pëllumb



Papagall



Mace




Luan



Dhi



Qen



Elefant



Lakuriqi i natës



Kalë



Dinozaurët



Dinozaurët ishin kafshët më të mëdha në botë. Ata jetuan në tokë dhe në ujë miliona vjet më parë. Kishte mbi shtatëqind lloje të ndryshme dinozauri. Disa ishin më të gjata se një shtëpi. Disa ishin më të vogëla se një qen.

Fosilet e para të dinozaurëve u gjetën në shekullin e 19-të. Në vitin 1842 Richard Owen i cili ishte paleontologu shpiku termin dinozaur. Shkencëtarët i ndanin dinozaurët në dy grupe; saurischians dhe ornithiaschians. Këtë ndarje e bënë duke u bazuar në strukturën e kockave të tyre.

Tyrannosaurus ishte mbreti i dinozaurëve dhe sigurisht më i famshmi. Ndryshe quhet edhe T-Rex. Ky lloj jetoj rreth 65 milion vjet më parë. Kishte dy këmbë dhe dy krah të shkurtër. Kishte një kokë të madhe me një gojë shumë të madhe dhe pesëdhjetë e tetë dhëmbë shumë të mprehtë. Ishte mishngrënëse.

Dinozaurët më të gjatë ishin Seismosaurus dhe Argentinosaurus. Ata jetuan në Amerikë rreth 150 milion vjet më parë. Seismosaurus ishin mbi 40 metra të gjatë nga hunda në bisht. Kishin një qafë të gjatë si gjirafë. Nuk kishin brirë. Ecnin sipër në katër këmbë. Nuk hanin mish por hanin gjethe, bar dhe bimë.

Ka pasur dinozaur që nuk ishin vegjetarianë, pra ishin mishngrënë, por pjesa më e madhe e tyre ishin vegjetarianë dhe hanin bimë dhe pemë të ndryshme.



8. Përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit me "e drejtë" ose "gabim".


E DREJTË (D) / GABIM (G)

1. T-Rex ka jetuar 100 milion vjet më parë.
2. Dinozaurët ishin kafshët më të mëdha në botë.
3. Fosilet e para të dinozaurëve u gjetën në shekullin e 16-të.
4. Shkencëtarët i ndanin dinozaurët në dy grupe; saurischians dhe ornithiaschians.
5. Tyrannosaurus ishte më i vogli i dinozaurëve.
6. T-Rex kishte dy këmbë dhe dy krah të shkurtër.
7. Dinozaurët më të gjatë jetuan në Amerikë rreth 150 milion vjet më parë.
8. Të gjithë dinozaurët ishin vegjetarianë.
9. Ka pasur dinozaur që nuk ishin vegjetarianë.
10. Ka pasur dinozaur të vegjël sa një qen.

9. Përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit.



1. Çfarë tregon teksti në përgjithësi?
 - o
 - o
2. Sa vite kanë kaluar pasi është shpikur termi dinozaur?
 - o
 - o
3. Në sa kategori ndahen dinozaurët dhe çfarë e dallon këtë kategori?
 - o
 - o
4. Me çfarë ushqeheshin në përgjithësi dinozaurët?
 - o
 - o
5. A i keni ditur më parë këto që lexuat në tekst? Çfarë ishte më interesante sipas jush?
 - o
 - o
 - o



Fakte nga Turqia

1. Turqia është vendi që konsumon më shumë çaj.

A e dini se rreth 96% e popullsisë së përgjithshme pinë të paktën 1 gotë çaj në ditë? Është vlerësuar se turqit konsumojnë 3 kilogram çaj për person në vit. Pra, nëse vizitoni Turqinë, atëherë nuk duhet të humbisni një përvojë tradicionale të çajit!

2. Gjysma e popullsisë në Turqi është nën 30 vjeç.

Ku 23% e moshës së popullsisë është nën 14 vjeç dhe më shumë se gjysma e popullsisë totale është nën 30 vjeç atëherë ajo është një popullatë e re. Në Turqi vetëm 8.5% e popullsisë është më e vjetër se 65 vjeç.

3. Turqia është shtëpia e qebapit.

Ndërkombëtarisht qebapi Doner ndoshta është më i famshmi, por në Turqi, janë disa lloje të qebapit. Turqit janë akoma më të mirët për ta bërë atë!

4. Stambolli është i vetmi qyteti i ndërtuar në dy kontinente.

Ky qytet antik është i vendosur kryesisht në kontinentin aziatik, por disa përqindje e sipërfaqes së përgjithshme të qytetit është vendosur edhe në Evropë. Dhe kjo gjë këtë qytet e bën atë unik.

5. Mundja me vaj është sport kombëtar.

Mundësit përpara se të fillojnë ndeshjen lyhen me vaj ulliri.

6. Kafeja u prezantua në Evropë nga Turqit.

Turqit e futën kafënë tek evropianët që në shekullin e 16-të.

7. Shteti është i mjaftueshëm për ushqim.

Rreth 49,7% e territorit turk është dedikuar për bujqësi. Ata nuk kanë nevojë të mbështeten në importimin e ushqimit nga vendet e tjera.

8. Bujqësia është thënë të ketë filluar në Turqi.

Historianët besojnë se bujqësia filloi në Turqi, më shumë se 11 000 vjet më parë. Ndoshta nuk është aq befasuese kur shikoni këtë fermer dhe sallatat gjigande, por është padyshim një nga faktet më interesante për Turqinë!

9. Syri blu për mësysh është gjëja më e blerë në Turqi.

Në turqisht, ajo njihet si "nazar boncuğu", dhe ka për qëllim të mbrohet kundër syrit të keq.

10. Ankaraja është kryeqyteti i Turqisë, jo Stambolli.

Shumë të huaj që nuk e dinë vendin mendojnë se Stambolli është kryeqyteti i Turqisë. Por kjo nuk është e vërtetë. Stambolli është qyteti më i madh në Turqi, por kryeqyteti është Ankaraja.



11. Përgjigjuni pyetjeve.

1. Sa fakte të ndryshme tregohen në tekst?

o

2. Cila nga ato ishte më interesante për ju?

o

3. A e dini se çfarë do të thotë "mësysh"?

o

4. A mund ta gjeni se cili vend tjetër në botë konsumon shumë çaj?

o

5. Mendo sikur ka ardhur një turist në shkollën tënde dhe tregoi atij/asaj disa gjera në lidhje me turqinë ose qytetin që jeton ti.

o

.....

.....

.....

.....

12. Mësoni edhe ju disa fakte në lidhje me Shqipërinë dhe mundohuni të shkruani një tekst.



Fakte nga Shqipëria

.....

.....

.....

.....

.....

.....

MĚSÍMÍ 9

13. Detyrat



A series of 20 horizontal wavy lines for handwriting practice, spanning the width of the page.

Handwriting practice lines consisting of 20 horizontal wavy lines.



Dinleme



Konuşma



Okuma



Yazma



ARGƏTİM



1. Dëgjoni dhe lexoni tekstin me vëmendje.

Dheu është flori



Një bujk plak para se të vdiste, thirri të tre bijtë pranë dhe tha:

- O bijtë e mi! Në arën që unë kam punuar gjithë jetën time dhe që me drithin e saj ju kam ushqyer dhe rritur deri tani, kam fshehur një qyp me florinj. Gërmoni thellë tokën dhe kërkoni në të katër anët e saj! Do të gjeni patjetër aty një qyp, i cili do t'ju pasurojë! Nuk do të jeni të varfër kurrë më!

Pas vd ekjes së plakut, të tre djemtë zunë të gërmonin arën thellë e më thellë. Mot për mot e thellonin nga një pëllëmbë më tepër, por qypin nuk e gjetën. Ara, duke u punuar thellë e më thellë, zuri të jepte mot për mot më tepër drithë. Të tre vëllezërit nxirrnin bukën e shtëpisë dhe u tepronte shumë për të shitur. Të hollat që fitonin, i hidhnin në një qyp për ti ruajtur. Për pesë vjet qypi u mbush me florinj.

Atëherë vëllezërit e kuptuan se për çfarë qypi me florinj kishte folur babi i tyre.

Sami Frashëri

2. Mundohuni të gjeni kuptimet e fjalëve me ngjyre të kuqe në tekst.



1.: Bimë barishtore njëvjeçare (si gruri, misri etj.) që bëjnë kokrra të grumbulluara në kalli, të cilat shërbejnë si ushqim për njerëzit e për kafshët; bimët e bukës.
2.: Gërmon në një vend dhe heq dheun për të hapur një gropë ose për të nxjerrë diçka të mbuluar.
3.: Enë balte e rumbullakët, e lartë që përdoret për të mbajtur bulmet, turshi e ushqime të tjera.
4.: Ai që punon tokën dhe rrit bimë bujqësore.
5.: Monedhë prej këtij metali, me një vlerë të caktuar.

MËSIMI 10

3. Përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit.



1. Çfarë i tha djemve plaku para se të vdiste?

o

2. Çfarë bënë djemtë?

o

3. A u bën të pasur djemtë?

o

4. A kuptuan djemtë qëllimin e babait?

o

5. Çfarë duhet të kuptojmë nga ky tekst?

o

4. Dëgjoni tekstin me vëmendje dhe i vini fjalitë në radhën e duhur. Qëllimi është të krijoni një tekst të saktë.



Dhelpra dhe cjapi

..... Një ditë një dhelpër ra në pus.

..... Një cjac e kishte marrë etja, dhe erdhi tek pusi për të pirë ujë.

..... Pastaj i tha; hajde më mirë këtu poshtë, se këtu e shijon më mirë.

..... U mundua sa u mundua por nuk doli dot.

..... Cjapi pranoi. Dhelpra kërceu në shpatullat e tij, qëndroi në brirë, doli prej pusit dhe filloi të largohet.

..... Pastaj vendosi të presë, sepse nuk dinte si të dalte.

..... - Si t'ja bëjmë tani? - tha cjac. Si do të dalim prej pusit?

..... Aty pa dhelpër brenda, dhe e pyeti:

..... Dhelpra i tha: Mos u bëj merak. Kam menduar unë për të dy. Shiko si do të dalim.

..... - O dhelpër, a është uji i mirë?

..... Dhelpra filloi ta lëvdojë e ta mburrë qartësinë dhe kthjelltësinë e ujit sa s'ka më.

..... Dhelpra u kthye e i tha: I dashuri cjac, sikur të kishe aq mend sa ke qime në mjekër, ti as që do të zbritje në pus para se të mendoje se s'do kishe për të dalë

..... Cjapi zbriti poshtë, pasi e kishte marrë etja pa se nuk dilte dot nga pusi.

..... Cjapi i thirri: - O dhelpër, po mua më harrove?

..... Çoji këmbët e para në murin e pusit dhe afroji brirët. Kur të ngjitem unë lart mbi kurrizin tënd, do të tërheq dhe do të ndihmoj edhe ty.

..... Cjapi e qortoi që nuk e mbajti fjalën e dhënë.



5. Shkruani përrallën sipas radhës të saktë.

Dhelpra dhe cjapi

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

6. Përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit.



1. Si fillon përralla?

°

.....

2. Çfarë i tha dhelpra cjapit?

°

.....

3. Çfarë duhet të kuptojmë nga ky tregim?

°

.....

4. Ti po të ishe në vendin e cjapit si do veproje?

°

.....

5. A mund të numëroni në klasë me zë se sa herë është përmendur "cjapi" dhe sa herë është përmendur "dhelpra"?

° Cjapi:

.....

° Dhelpra:

.....

MËSIMI 10

7. Të bëjmë një rikujtim të shpejtë. Mundohuni të shkruani me fjalitë tuaj.



Ngjyrat e verës janë

.....
.....
.....

Unë në verë ndihem i/e

.....
.....
.....



Ngjyrat e pranverës janë

.....
.....
.....

Unë në pranverë ndihem i/e

.....
.....
.....



Ngjyrat e dimrit janë

.....
.....
.....

Unë në dimër ndihem i/e

.....
.....
.....



Ngjyrat e vjeshtës janë

.....
.....
.....

Unë në vjeshtë ndihem i/e

.....
.....
.....

8. Të mësojmë sinonimet, antonimet dhe homonimet.

Sinonim, antonim dhe homonim

- Sinonimet janë fjalë, të cilat shkruhen ndryshe, por që kanë kuptim të njëjtë me njëra-tjetrën.
- Antonimet janë fjalë, të cilat kanë kuptim të kundërt me njëra-tjetrën.
- Homonimet janë fjalë që shkruhen ose shqiptohen njësoj, por që kanë kuptim të ndryshëm.

Disa shembuj:

a. Sinonim: fshat – katund

grua – femër

nxënës – student

i bukur – i pashëm

atdhe – mëmëdhe

dera – porta

- Këtë fundjavë do shkojmë në fshat. Gjyshja ime jeton në katund.
- Dera e shtëpisë ka mbetur hapur. Mos harro ta heqësh çelësin nga porta!
- Shoqja ime është shumë e bukur! Mendoj se ai është njeri i pashëm.
- Ai u kthye në atdhe. Njeriu nuk e harron kurrë mëmëdheun!

b. Antonim: qaj – qesh

i shkurtër – i gjatë

pak – shumë

i bukur – i shëmtuar

i hollë – i trashë

hap – mbyll

- Unë jam një njeri që qaj shumë. Në kinema kam qeshur shumë.
- Në mëngjes kam ngrënë pak bukë. Më pëlqen shumë të ha kulllore.
- Pema që është në oborr është e hollë. Pema që është në pyll është e trashë.
- Të lutem hape kompjuterin! Mund ta mbyllësh dritën e dhomës.

c. Homonim: bar – bar

vesh – vesh

hap – hap

- Shkova për të blerë bar në farmaci. Këtë vit në kopsht kishte shumë bar.
- Sot veshja një fustan të kuq. Ai i ka veshët shumë të mëdhenj.
- Duhet të hedhësh edhe një hap tjetër. Sot u hap shkolla.

MËSIMI 10

9. Tregoni cilat nga fjalët e mëposhtme janë sinonim, antonim dhe homonim.

Fuqi, zi, keq, vesh, mbyll, qëndroj, mirë, dhe, hap, mësues, dhe, arsimtar, bardhë, rri, forcë, vesh

Sinonim:	Antonim:	Homonim:
.....
.....
.....
.....
.....
.....

10. Krijoni tre tekste të shkurtra të cilat të kenë sinonime, antonime dhe homonime.

Teksti me sinonime:

.....

.....

.....

.....

Teksti me antonime:

.....

.....

.....

.....

Teksti me homonime:

.....

.....

.....

.....



11. Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vendosni në vendet boshe fjalët e duhura të dhëna në fillim.

Çokollatë sheqerin nevojë ushqimet njerëzit
famshme nxehtë udhëtimit mjekësore hidhur kakaoja

Historia e çokollatës

Një nga më të njohura të të gjitha kohërave është çokollata. Njerëzit në ditët e sotme hanë çokollatë në forma të ndryshme. Për shembull ne hamë në formë karamele ose e pimë çokollatën si pije të dhe të ftohtë. Përbërësi më i rëndësishëm i çokollatës që hamë është

Historia e kakaos dhe të saj i gjatë në supermarkete dhe në të gjithë botën filloi qindra vite më parë në Meksikë. Pemët e kakaos kanë për mot të nxehtë dhe të lagësht, dhe ato fillimisht u rritën në një gadishull.

Majat kanë qenë e parë që e kanë përdorur kakaon. Ata e kanë përdorur kakaon si pije, si pjesë e ceremonive fetare dhe madje si para.

Fillimisht, shije e e kakaos, e ka bërë të përshtatshëm për t'u përdorur edhe për qëllime Sidomos është përdorur si një shërues për ata që kishin problemet e barkun. Por në kohët e mëvonshme spanjollët i shtuan vaniljen dhe për ti hequr shijen e hidhur.

Mund të themi se çokollata në ditët e sotme është bërë e në të gjithë botën.

12. Gjeni cila nga fjalitë e mëposhtme nuk përputhet me tekstin.



- Njerëzit në ditët e sotme hanë çokollatë në forma të ndryshme.
- Është përdorur si një shërues për ata që kishin problemet e mendjen.
- Në ditët e sotme është shumë e famshme.
- Majat kanë qenë njerëzit e fundit që e kanë përdorur kakaon.
- Historia e kakaos ka filluar në Meksikë.
- Përbërësi më i rëndësishëm i çokollatës është kakaoja.

MËSIMI 10

13. Përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit.



1. Për çfarë bëhet fjalë në tekst?

.....

.....

2. Trego në cilat forma të ndryshme përdoret çokollata?

.....

.....

3. Sa kohë ka ekzistenca e kakaos?

.....

.....

4. Si duhet të jetë moti për kakaon?

.....

.....

5. Në fillim për çfarë është përdorur kakaolja?

.....

.....

6. Kush e ka ëmbëlsuar kakaon?

.....

.....

7. A e kishë ditur historinë e çokollatës ?

.....

.....

8. Shkruaj diçka interesante në lidhje me çokollatën e cila nuk është në tekst.

.....

.....

9. A të pëlqen çokollata?

.....

.....

10. Si e preferon çokollatën, si pije apo si ushqim?

.....

.....



14. Mundohuni të gjeni nga 3 fjalë sipas pyetjes brenda 5 minutave. Kush nuk i shkruan anulohet nga loja.

1. 3 gjëra që mban në çantën e shkollës?

2. 3 ushqime që janë me perime?

3. 3 shtete që janë në Evropë?

4. 3 fjalë që fillojnë me shkronjën "th"?

5. 3 muajt e fundit të vitit?

6. 3 kryeqytete?

7. 3 profesione?

8. 3 gjëra që ndodhen në dhomën e gjumit?

9. 3 gjëra që ndodhen në klasë?

10. 3 bulmetra?

11. 3 kafshë që fillojnë me shkronjën "m"?

12. 3 veshje për femra?

13. 3 veshje për meshkuj?

14. 3 karakteristika të njeriut?

15. 3 parafjalë?

16. 3 mjete udhëtimi?

17. 3 vende që ka rregulla?

18. 3 enë gatimi?

19. 3 mënyrë të gatimit?

20. 3 gjëra që ndodhen në kuzhinë?

MĚSÍMÍ 10

15.

Dětyrat



Handwriting practice lines consisting of 20 horizontal rows of wavy lines.

A series of 20 horizontal wavy lines for handwriting practice, spanning the width of the page.



Dinleme



Konuşma



Okuma



Yazma



PLANET E JUAJA PËR TË ARDHMEN

NESËR DO TË ...



1. Dëgjoni tekstin "Besa e Kostandinit".



Besa e Kostandinit

Na ishte njëherë një nënë që i kishte dymbëdhjetë bij të pashëm. Të trembëdhjetën kishte një bijë të bukur mbi të gjitha shoqet, e cila quhej Doruntinë. Vasha u rrit e u bë për t'u martuar. Mirëpo nga bujarët e atij vendi askush nuk e gëzoi. Të gjithë e dëshironin askush s'guxonte ta zërë nuse, sepse nuk e ndjente veten të zotin për ta marrë për grua. Atëherë na vjen një trim i largët; i mirë, i pashëm, i fisëm dhe nis dërgon shkesë dallëndyshen që ta kërkojë Doruntinën nuse. Nëna dhe njëmbëdhjetë vëllezërit e mëdhenj nuk donin t'ia jepnin, sepse trimi ndonëse i mirë e i fisëm, ishte nga një vend shumë i largët. Vetëm i vogli, Kostandini donte dhe i premtoi nënës që do ta sillte sa herë që ajo do të kishte nevojë: "Të jap besën zonja nënë, se kur të duash ti Doruntinën, qoftë për gaz e qoftë për hidhërim, vete unë e ta sjell!".

Nëna dhe njëmbëdhjetë vëllezërit u bindën dhe e martuan Doruntinën me trimin e largët. Bënë dasmë nëntë ditë. Të dhjetën trimi mori nusen e shkoi te dheu i tij. Nëna e vasha qanë me lot kur u ndanë ... Shumë luftëra u luftuan atë mot. Të dymbëdhjetë vëllezërit dolën të luftojnë për vendin e tyre dhe u vranë një pas një të gjithë. Nëna dymbëdhjetë djem kishte pasur, dymbëdhjetë varre kishte tani... Ajo qau mbi çdo varr nga njëherë po mbi varrin e Kostandinit dy herë:

- Kostandin, o biri im, ku është besa që më dhe? Besa jote nën dhe! Kalbet në varr të zili!

Kështu tha dhe e lau gurin me lotët e syve. Në mesnatë Kostandini u ngrit nga varri. Guri i varrit u bë kalë i zi si nata. Edhe dheu i zi u bë shalë e zezë si nata. Rrotulla që mbante gurin u bë fre i argjendtë. Trimin i hipi kalit kaptoi si frymë male e fusha, hodhi lumenj e përrenj, la prapa katunde, kodra, pyje... Kostandini arriti te shtëpia e motrës kur kishte dalë dielli. Në shesh, përpara shtëpisë, gjeti të bijtë e të motrës, nipërit e tij, që loznin e vraponin pas dallëndysheve. I pyeti:

- Bij të zemrës, ku është zonja, nëna juaj?

- Nëna jonë po hedh valle në fshat, atje tek bëhet dasmë - i thanë ata.

MËSIMI 11

Kostandini vajti atje dhe u mat të pyesë, po Doruntina e pa vetë dhe i thirri:

- Kostandin, o im vëlla!

Dhe iu afrua e përqafoi. Kostandini i tha:

- Doruntinë, motra ime! Eja të shkojmë. Të do zonja nënë në shtëpi!

- Më thuaj vëlla, si të vij? Po të me doje për gaz, të vete të marr stolitë më të mira, po të më doje (mos qoftë e thënë) për hidhërim, do vete të vishem me të zeza.

- Eja motër, ashtu si je!

...

- Kostandin vëllai im, përse vëllezërit e mi të bukur si drita, s'kanë dalë përpara të na presin? Kostandin vëllai im, përse dritaret e shtëpisë janë mbyllur sot krejt?

- Doruntinë motra ime, i kemi mbyllur se fryn erë e fortë e dimrit nga deti.

Kur arritën Kostandini i tha motrës:

- Ti shko përpara se unë do të vij pas pak!

Kostandini shkoi e hyri prapë në varr të zi. Kali u bë prapë gur, shala u bë dhe, dhe freri i argjendtë u bë rrotullë. Dhe përsëri rreth e qark zotëroi heshtja e vdekjes. Ndërkaq Doruntina ngjiti shkallët dhe trokiti gazmend në derë.

- Nënë hapma derën!

- Kush je ti që trokëllin aty tek dera?

- Hapma zonja nënë - Jam bija jote, Doruntina.

- Ikë tutje nga ke ardhur o vdekje e shkretë. Ti m'í more të dymbëdhjetë bijtë e tani ke ardhur të më marrësh dhe mua që të mos e shoh më Doruntinën time!

- Çfarë po thua ashtu zonja nënë? Nuk ma njuh zërin? Besa zonja nënë, jam unë vete, Doruntina jote.

- Vëre gishtin tek vrima e kyçit që të ta shoh e nga aty mund të njoh.

Doruntina vuri gishtin e vogël tek vrima e kyçit - atë gisht të hollë e të bardhë. Nëna ia njohu sakaq e i hapi derën.

- Kush të solli këtu, o zemra ime?

- Më solli Kostandini, im vëlla.

- Cili Kostandin, moj bijë? Kostandini im ka vdekur bashkë me vëllezërit e tjerë. U vranë në luftë...

Dhe si rrinin të dyja, njëra tek pragu e tjetra në derë, plasën si qelqi...

Ismail KADARE

(Marrë nga romani "Kush e solli Doruntinën")

5. Mësoni kohën e ardhme të dëftores.



Koha e ardhme

E ardhme	E ardhme e përparme	E ardhme e së shkuarës	E ardhme e përparme e së shkuarës
do të mëso-j	do të kem mësuar	do të mëso-ja	do të kisha mësuar
do të mëso-sh	do të kesh mësuar	do të mëso-je	do të kishe mësuar
do të mëso-jë	do të ketë mësuar	do të mëso-nte	do të kishte mësuar
do të mëso-jmë	do të kemi mësuar	do të mëso-nim	do të kishim mësuar
do të mëso-ni	do të kenë mësuar	do të mëso-nit	do të kishit mësuar
do të mëso-jnë	do të kenë mësuar	do të mëso-nin	do të kishin mësuar

Duhet të dimë: Në gjuhën shqipe letrare dallohen dy tipa të së ardhmes. Tipi i parë; formohet duke u paravendosur pjesëzën "do" formave vetore të kohës së tashme të mënyrës lidhore: do të kem, do të jem, do të mësoj etj. Tipi i dytë; ndërtohet duke i paravendos formës së pashtjelluar të tipit për të mësuar, format vetore të kohës së tashme të foljes ndihmëse "kam": kam për të pasur, kam për të qenë, kam për të mësuar etj. Tipi i parë është më i përdorur se tipi i dytë.

6. Vini në kohën e ardhme, në veten e duhur foljet në kllapa.



Nesër do të shkoj (shkoj) në librari. Aty(blej) një libër të gjeografisë. Arbeni (shikoj) në televizor ndeshjen miqësore të futbollit Shqipëri – Turqi. Arrita, ç’..... (bëj) sot pas mësimit? Të martën (kam) pesë orë mësimi. Ekspozita tani (jam) hapur. Sot në mbrëmje në shtëpinë e Arjetës (vij) familja e Keremit për darkë. Cilin libër (lexoj) tani. Javën tjetër Leka (filloj) në kurs të tenisit. Enda dhe Nina për herë të parë (luaj) balet sot në skenë. Ti dhe Joni çdoherë (gjej) një arsye për t’u vonuar.

7 *Vini në kohën e ardhme, në veten e duhur foljet në kllapa.*

1. Unë dhe Deoni do të shkojmë në Izmir.
2. Ti do të marrësh një libër në bibliotekë.
3. Albini do të fotografojë malet e Shqipërisë.
4. Ne do të nisemi në një rrugë të gjatë.
5. Si do të jetë moti nesër.
6. Blerta do të fluturojë nga gëzimi.
7. Çfarë do të vizatoj unë tani?
8. Vëllai do të blejë një kapelë të bukur.
9. Babai dhe unë do të këndojmë bashkë.

◦ Unë dhe Deoni shkojmë në Izmir.

-
-
-
-
-
-
-
-
-

Duhet të dimë: E ardhmja e së shkuarës dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës së dëftores janë homonime me format gramatikore të kohës së tashme dhe të së kryerës së mënyrës kushtore.

8. *Foljet e kohës së ardhme të së shkuarës zëvendësoni me kohën e ardhme.*

◦ Çfarë do të doje për ditëlindje?

◦ Do të doja një parashutë.

◦ Një parashutë!? Pse? Çfarë do të bëje me të?!

◦ Do ta merrja me vete Sokolin dhe do të shëtisnim së bashku.

◦ Ide e bukur. Cilat vende do t'i vizitonit me Sokolin?

◦ Së pari do të fluturonim mbi Shqipëri, pastaj mbi Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Kroaci, Itali, Sicili e Kalabri.

9. *Gjeni foljet duke i nënvizuar dhe tregoni se në cilën kohë janë ato.*

- a. Në të vërtetë do të doja [A. Shk.] projektin e Nardit.
- b. Do të ha edhe unë një akullore.
- c. Ardiana dhe Ardita do të kishin ditur të qëndisnin.
- d. Ammari dhe Hafsja do ta gëzojnë të motrën.
- e. Nea do të ketë dalë të vrapojë në mëngjes.
- f. Rymejsa dhe doktor Inani do të kishit qenë kujdestarë.
- g. Do të kesh zënë një peshk.
- h. Unë do të kem punuar këtu për pak kohë.
- i. Ti do të telefonosh drejtorin e kompanisë.

MËSIMI 11

10. Shkruani planet e juaja për të ardhmen, duke përdorur kohën e ardhme.



A series of 20 horizontal wavy lines for handwriting practice, spanning the width of the page.



11. Dëgjoni tregimet e bëra në klasë prej shokëve e shoqeve të klasës si dhe zgjidhni punimin më të mirë. Mos harroni t'i vini titull tregimit. Mundësisht së bashku me mësuesin / mësuesen diskutoni planet e shokëve / shoqeve të klasës.

12. Mësoni mënyrën habitore dhe mënyrën lidhore.



Duhet të dimë: Nëse veprimi paraqitet si i vërtetë mirëpo shoqërohet me ndjenjën e habitësë themi se folja është në mënyrën habitore. Ndërsa nëse veprimi paraqitet si i mundshëm themi se folja është në mënyrën lidhore. Që të dyja i kanë dy kohë kryesore kohën e tashme dhe kohën e shkuar (të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën).

- Paskeni pasur të drejtë që të dy.
- Djaloshi dika goxha shumë.

Mënyra habitore

Koha e tashme	Koha e shkuar		
	E pakryera	E kryera	Më se e kryera
Unë mësua-kam	mësua-kështa	paskam mësuar	paskështa mësuar
Ti mësua-ke	mësua-këshe	paske mësuar	paskëshe mësuar
Ai / ajo mësua-ka	mësua-kësh	paska mësuar	paskësh mësuar
Ne mësua-kemi	mësua-këshim	paskemi mësuar	paskëshim mësuar
Ju mësua-keni	mësua-këshit	paskeni mësuar	paskëshit mësuar
Ata / ato mësua-kan	mësua-këshin	paskan mësuar	paskëshin mësuar

- Arditi duhet të mësojë për të kaluar provimin.
- Të notosh në drejtim të dallgëve, është më vështirë se t'i çash ato.

Mënyra lidhore

Koha e tashme	Koha e shkuar		
	E pakryera	E kryera	Më se e kryera
Unë të mëso-j	të mëso-ja	të kem mësuar	të kisha mësuar
Ti të mëso-sh	të mëso-je	të kesh mësuar	të kishe mësuar
Ai / ajo të mëso-jë	të mëso-nte	të ketë mësuar	të kishte mësuar
Ne të mëso-jmë	të mëso-nim	të kemi mësuar	të kishim mësuar
Ju të mëso-ni	të mëso-nit	të keni mësuar	të kishit mësuar
Ata / ato të mëso-jnë	të mëso-nin	të kenë mësuar	të kishin mësuar

MËSIMI 11

13. Mësoni zgjedhimin e foljeve kam dhe jam të kohës së tashme të mënyrës habitore dhe të asaj lidhore.



Kam: (unë) paskam, (ti) paske, (ai / ajo) paska, (ne) paskemi, (ju) paskeni, (ata / ato) paskan.
Jam: (unë) qenkam, (ti) qenke, (ai / ajo) qenka, (ne) qenkemi, (ju) qenkeni, (ata / ato) qenkan.
Kam: (unë) të kem, (ti) të kesh, (ai / ajo) të ketë, (ne) të kemi, (ju) të kenë, (ata / ato) të kenë.
Jam: (unë) të jem, (ti) të jesh, (ai / ajo) të jetë, (ne) të jemi, (ju) të jeni, (ata / ato) të jenë.

14. Lexoni tekstin me vëmendje. Mos harroni t'i nënvizoni foljet.



Bilge në koncert të operës

Ishte hera e parë që Bilge do të shkonte në koncert të operës. Ajo kishte marrë tri bileta, atë e shoqëronin edhe Dituria e Endriti. Në hyrje të Teatrit të Operës dhe të Baletit kishte shumë rrëmujë.

- Më duket se nuk paska ngelur më bileta. Shikoni sa rrëmujë që është, - tha Endriti.
- Sa mirë që i paskëshe marrë biletat më herët Bilge, përndryshe do të ngelnim edhe ne jashtë, - foli pa hezitim Dituria.
- E kisha ëndërr që të shkoja në koncerte të operës prandaj i mora më herët biletat, - u përgjigje Bilge duke qeshur.

Të tre shokët u ngjitën shkallëve të pallatit dhe u futën brenda. Salla me të vërtetë ishte mjaft e madhe dhe dukej shumë madhështore. Pas pak u hap perdja dhe në skenë doli moderatorja dhe paraqiti programin. Pas pak filluan të dëgjohej tingujt e veglave muzikore e më pas filluan të dalin në skenë artistë të tjerë.

- Opera "Lulja e kujtimit" për herë të parë është interpretuar në vitin 1961. Ajo është vepër e Artistit të Popullit Kristo Kono, - tregoi Endriti.
- Unë e kam lexuar romanin "Lulja e kujtimit" prandaj paskam shumë emocione, - foli me zë të dridhur Bilgeja.
- Qetësi se filloi, atëherë shokë dashkemi ta dëgjojmë me vëmendje - tha Dituria.

Të gjithë qeshën për ca sekonda por menjëherë pushuan.

15. Shkruani foljet e nënvizuara të mënyrave habitore dhe lidhore në tekstin e sipërme. Mos harroni të tregoni kohën se cilës i përkasin foljet në fjalë.



Mënyra habitore

Mënyra lidhore

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

16. Vendosni në mënyrën habitore foljet që janë poshtë në kllapa.

Teuta e ditka (di) këtë më parë këtë film. Mësuesja e Lules i (do) shumë nxënësit dhe i (pëlqej) t'i mësojë ata. Sa vendi bukur, sa shumë (ndryshoj) pamja e këtyre maleve. Babi yt nuk (punoj) ai (dal) në pension. Nuk (dëgjoj) deri më tani një zë kaq të bukur. Bartu e (di) shumë mirë shqipen.

17. Ktheni fjalitë e mëposhtme nga mënyra habitore në mënyrën dëftore, po në atë kohë që janë dhënë.

1. Në qytetin e Prizrenit Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër "DokuFest" qenka bërë simbol i qytetit të Prizrenit!
 - Në qytetin e Prizrenit Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër "DokuFest" është bërë simbol i qytetit të Prizrenit!
2. Ozani ditka t'i bjerë kitarës shumë bukur!
 -
3. Vlora ia paska vënë djalit emrin Flamur!
 -
4. Nga gjyshja e paska mësuar ai këtë përrallë.
 -
5. Sot në qiell nuk paska erë!
 -
6. Para ca ditësh paska rënë shi në fshatin tim!
 -

18. Vini në mënyrën lidhore foljet e dhëna.

Ty dyja motrat kanë etje, prandaj duan të hanë (ha). Mendoj (flas) kështu, tha Abdyl. Mehmeti filloi (bëj) detyrat e shtëpisë. Duhet (ushtroj) shumë që të kaloj provimin e matematikës. Është mirë (provoj) edhe supën nënën – thotë Agoni. Unë dua (recitoj) një vjershë para shokëve të klasës – tha prerazi Ada e vogël.

19. Vini në formën e duhur fjalët në kllapa.

1. Në (tavolina ime) ka dy (vazoja).
 - Në tavolinën time ka dy vazo.
2. Toka (Durrës) u lëkund këtë (viti).
 -
3. Emelja sot filloi (shkruij) një (roman i ri).
 -
4. Deti do të marrë me vete edhe (motra).
 -
5. Për (cila skuadër) anoni ju.
 -
6. Nëna ka mbushur (shportë) me fruta e perime.
 -
7. Më duhet të marr me vete (çantë Artan).
 -
8. Sonte ne (dëshiroj) (ha) darkën në restorantin e Kalasë (Ulqin).
 -

MĚSÍMÍ 11

20. Detyrat.



A series of 20 horizontal red wavy lines, intended for handwriting practice.

A series of 20 horizontal wavy red lines, spaced evenly down the page, intended for handwriting practice. The lines are consistent in height and width, providing a guide for letter formation.



Dinleme



Konuşma



Okuma



Yazma

MƏSİMİ

12




PO AFROHEN PUSHIMET VERORE



1. Dëgjoni tekstin e poshtëm "Hoxha Hasan Tahsin".

HASAN TAHSINI



Hoxha Hasan Tahsini (1832-1884) ishte nga fshati Ninat i Çamërisë, por jetoi e punoi në Stamboll. Shkencëtar i flaktë, ai bashkëpunoi me Pashko Vasën, Jani Vreton, Ismail Qemalin, Sami Frashërin etj. Ai ishte një punëtor i palodhur dhe njeri me zemër të madhe. Megjithëqë në vendin tonë pothuaj nuk ka njeri që nuk e dinë këtë emër, janë fare të pakët ata që e kanë njohur e kuptuar siç duhet. Unë kam pasur fatin të njihem dhe të kem biseduar shumë me të, kështu që i kam njohur deri në njëfarë shkalle mendimet dhe natyrën e tij dhe përherë kam mbetur i habitur nga virtytet e tij të larta.

Pasi kreu studimet, në medresetë e kryeqytetit, duke përvetësuar dituritë arabe e islame dhe letërsinë e Lindjes, Hoxha Tahsini vajti në Paris, ku bashkë me gjuhën frënge, studioi të gjitha shkencat e reja të asaj kohe. Nuk e hiqte kurrë librin nga dora. Vendi ku banonte dhe shtrati ku flinte ishte i rrethuar me libra; leximin e ndërpriste vetëm kur mësonte të tjerët. Nuk i shmangej bisedës me të tjerët, por edhe biseda e tij ishte një mësim, një diskutim diturie; nuk

kënaqej fare nga fjalët e kota që nuk sillnin ndonjë dobi dhe sidomos nga bisedimet për çështje vetjake. Në të tilla raste ua priste me zemërim fjalët atyre që flisnin të tilla dhe nuk duronte të bisedohej për çështje që nuk kishin të bënin me diturinë, shkencën, të vërtetën dhe drejtësinë. Ai vetë ishte dashamirës i diturisë, i shkencës, i drejtësisë dhe i së vërtetës. Fjalët "të kërkosh të vërtetën" ishin ato që përsëriteshin më shpesh nga goja e tij.

Nëse themi se sot në vendin tonë titullin e dijetarit nuk e meriton njeri tjetër më shumë sesa Hoxha Tahsini, mendoj se me këtë nuk i kemi hidhëruar njerëzit e tjerë të dijes e të shkencës. Njohuritë e tij në shkencat e fizikës, në shkencat natyrore, në ato të matematikës e të astronomisë nuk janë të sipërfaqshme. Ai i zotëronte plotësisht këto dituri bashkë me zbatimet e tyre. Aq shumë i kishte përvetësuar ligjet e rregullat e këtyre shkencave dhe që shtrirë plotësisht me to, sa që për asnjë temë a çështje shkencore nuk kishte nevojë të hapte librat.

...

Hoxha Tahsini e shikonte racën njerëzore si një familje të madhe e të vetme dhe të gjithë njerëzit si vëllezër. Ai dëshpërohej shpirtërisht nga ndarja e përçarjet e tyre. Ai e quante të nevojshme përmirësimin e gjendjes së racës njerëzore në përgjithësi. Dëshira e zemrës së tij fisnike dhe lutjet e tij ishin për të mirën e dobinë e krejt njerëzimit. Hoxha Tahsini ka qenë nga njerëzit e mëdhenj që shumë rrallë me vështirësi i lindin shekujt dhe epokat. Nga dituria, virtyti, shkenca, idetë dhe nga veprimtaria e tij, bijtë e atdheut mund të përfitonin shumë. Në mësimet e tij ndodheshin përmbri të pranishëm pesë deri dhjetë nxënës të zellshëm për arsim. Në këtë mënyrë Hoxha Tahsini punoi së tepërmi për përhapjen e diturive e të shkencave të ndryshme dhe për zhdukjen e paditurisë.

Sami FRASHËRI

5. *Gili / cila prej jush e ka lexuar romanin e parë të letërsisë turke "Dashuria e Talatit dhe e Fitnetës" të Sami Frashëri. Diskutoni në klasë me mësuesin / mësuesen si dhe shokët / shoqet e klasës këtë vepër.*



6. *Mësoni rregullat se si bëhet një shkrim në gazetë.*



1. Gazetari duhet të jetë më objektiv në ngjarjen që shkruan.
2. Titulli duhet të shkruhet me shkronja të mëdha që të jepet njoftimi kryesor i asaj që ka ndodhur.
3. Nën nëntitull duhet dhënë një përmbledhje të shkurtër të asaj që është më e rëndësishme lidhur me ngjarjen.
4. Fjalët e autorit duhet të jenë tepër të sakta dhe me karakter njoftues.
5. Për t'u bërë më i besueshëm shkrimi fjalët e të intervistuarit duhet të jepen në thonjëza.
6. Shkrimi përgjithësisht duhet shoqëruar me fotografi.

7. *Duke u mbështetur në rregullat e sipërme shkruani një shkrim.*




MËSIMI 12

Libër

8. Mësoni gjymtyrët e dyta të fjalisë.

Duhet të dimë: Fjalía e thjeshtë, përveç gjymtyrëve kryesore, kryefjalës dhe kallëzuesit ka edhe gjymtyrë të tjera që i quajmë **gjymtyrë të dyta**. Këto gjymtyrë i plotësojnë, sqarojnë dhe përcaktojnë gjymtyrët kryesore. Gjymtyrët e dyta ndahen në tri kategori të mëdha: **përcaktorë, kundrinorë dhe rrethanorë**.



Libër

9. Mësoni përcaktorin.

Duhet të dimë: Përcaktori shprehet zakonisht me **emër, mbiemër dhe përemër**. Llojet e përcaktorit janë: **me përshtatje, me drejtim, me bashkim dhe ndajshtim**. Përcaktorët me përshtatje dhe përcaktorët me drejtim përdoren më shpesh.

- ° Rrezet e **arta të diellit** binin mbi çati. * (Përcaktor me drejtim).
- ° Ja dhuroi nënën një buqet **lulesh**. * (Përcaktor me drejtim).
- ° Besoj se **ky djalë** do të arrijë kulmin. * (Përcaktor me përshtatje).
- ° Topi i **rumbullakët** u rrotullua rreth teje. * (Përcaktor me përshtatje).

10. Krijoni grupe emërore duke bashkuar emrin bërthamë me një përcaktor.

1. Telefoni; e klasës. °
2. Sheshi; i Burimit. °
3. Dera; e kuqe. °
4. Babai; i kaltër. °
5. Kapela; i qytetit. °
6. Fshaq; i tij. °
7. Qielli; i gëzuar. °
8. Fëmijë; ky. °





11. Nënvizioni përcaktorët në tekst. Sipas modelit të dhënë plotësoni tabelën.

Po afrohen pushimet e verës dhe Teuta nuk di se ku të shkojë për pushime. Ajo futet në internet dhe fillon të kërkojë vendet bregdetare shqiptare. Aty gjeti Durrësin, Ksamili, Vlorën, Dhërminë, Himarën dhe Sarandën.


- Shqipëria me të vërtetë është vend i bukur, ajo përkufizohet me Detin Adriatik dhe Detin Jon. Më mirë ta marrë në telefon Agronin e ta pyes njëherë edhe atë - tha me vete Teuta.
- Alo Agron, si je?
- Përhëndetje Teutë. Mirë jam faleminderit. Po ti si je?
- Mirë jam i dashur Agron. Desha të konsultohem me ty. Unë kam para hartën e Shqipërisë dhe nuk di se ku të shkoj për pushime - pyeti përsëri Teuta.
- Mund t'i bësh pushimet në Durrësin e lashtë, mund të shkosh edhe në Theth atje është shumë bukur po ashtu. Mos harro ke edhe liqenin e Prespës dhe të Pogradecit - foli Agroni.
- Ashtu, ide e bukur mund të shkoj ta vizitoj edhe liqenin e Ohrit.
- Tani mu kujtua edhe një tjetër vend i mrekullueshëm është Ulqini me kalanë madhështore.
- Tani ma bëre kokën lëmsh fare, - tha Teuta.

Grupi emëror	Bërthama e grupit	Përcaktorët	Me se shprehen
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

12. Mësoni kundrinorin.



Duhet të dimë: Kundrinori si gjymtyrë e dytë e fjalisë zakonisht varet nga folja. Ai tregon se mbi kë bie veprimi i shprehur. Sipas kuptimit dhe formës së shprehjes ai mund të jetë i drejtë dhe i zhdrejtë.



MËSIMI 12

Kundrinori i drejtë shprehet:

- me emër në rasën kallëzore:
- me përemër:
- me grup emëror:
- me trajtë të shkurtër të përemrit vetor:
- * Të lutem mbylle **derën**.
- * Shikoje **atë** si është bërë.
- * Jam shumë i zënë **këtë javë**.
- * Dea sot do ta marrësh një **telefonat**?

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë shprehet:

- me emër:
- me përemër:
- me grup emëror:
- * **Drejtorit** nuk i treguan historinë.
- * Të gjitha gënjeshttrat **ty** të dolën në shesh.
- * **Qytetit tonë** ky festival ia ngriti namin.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë shprehet:

- me emër:
- me përemër në rasën emërore, kallëzore dhe rrjedhore me parafjalë:
- * Drejtorit nuk i treguan historinë.
- * Ti duhet të vish **me mua** Arta.

13. Nënvizoni kundrinorin e drejtë në fjalitë e poshtme dhe thoni se me shprehet ai:

p.sh.: kopshtin; kundrinor i drejtë, shprehur me emër në rasën kallëzore, numri njëjës, gjinia femërore dhe trajta e shquar.

1. Në (tavolina ime) ka dy (vazoja).
◦
2. Toka (Durrës) u lëkund këtë (viti).
◦
3. Emelja sot filloi (shkruaj) një (roman i ri).
◦
4. Deti do të marrë me vete edhe (motra).
◦
5. Për (cila skuadër) anoni ju.
◦

14. Në fjalitë e dhëna gjeni kundrinorët, kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë nënvizoni me ngjyrë të kuqe ndërsa kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë me ngjyrë blu.

Nëna habitej me të bijën. Blertës i është dhënë vendi i parë. Njeriu mundohet për bukën e gojës. Nga këto histori ka popullli ynë. Dje takova Petritin. Tani reja do të bije mbi çati. Nga mëngjesi nis të këndojë ky. Gjyshërit tanë udhëtonin me kalë. Se çfarë ka ai me ty? Cani u has në kundërshtim me të atin. Nuk i këndohet kështu shokut. Jetën nuk mund ta njohësh vetëm nëpërmjet librave. Çdoherë jam sjellë mirë ndaj teje. Dua të shkruaj një vjershë rreth pushimeve të verës. Në mëngjes u nisa rreth bregdetit por nuk të gjeta. Luanit i frikësohen të gjitha kafshët e pyllit. Nuk të takon ty të flasësh. Këto lule do t'ia dërgojmë mësuesit për 7 mars.



21.

Shkruani se cilat janë planet e juaja për pushimet e verës.

Handwriting practice area consisting of 20 horizontal wavy orange lines.

MĚSÍMÍ 12

22. Detyrat.



A series of 20 horizontal wavy lines, resembling a handwriting practice guide, spanning the width of the page.

A series of 20 horizontal wavy orange lines, spaced evenly down the page, intended for handwriting practice. The lines are consistent in color and wave pattern.

FJALOR

A

afër (i,e): Yakın (mesafe)
afërm (i,e): Yakın (akraba, insan Vb.)
afroj: Yaklaşmak
aftësi: Yetenek
akoma: Hala
aktivitet: Aktivite
aktor: Aktör
akullore: Dondurma
alfabet: Alfabe
ambient: Ambiyans
anë: Taraf, Yan
angazhuar (i,e): Meşgul
antik: Antik
antonim: Zıt anlamlı kelimeler
aparət: Aparat, araç gereç
arë: Tarla
argumentoj: Kanıtlamak
argjend: Gümüş
arkitekturë: Mimar
arsim: Eğitim
arsimtar: Eğitimci
arsye: Neden
art: Sanat
artikull: Makale, yazı
artist: Artist
arrij: Varmak
arritje: Varış
asgjë: Hiç bir şey
askujt: Hiç kimse
asnjë: Hiçbiri
aspekt: Bağlam
astronomi: Astronomi
atdhe: Anavatan
atëherë: O zaman
atje: Orada
aty: Orada
autentikë: Otantik
avantazh: Avantaj
avash: Yavaş
Azi: Asya

B

baba: Baba
badminton: Badminton
bajrami i kurbanit: Kurban bayramı
bajrami i madh: Ramazan bayramı
bakter: Bakteri

balenë: Balina
balet: Balet
baltë: Çamur
banane: Muz
bankë: Sıra
banorë: Nufüs
bar: Çimen
bardhë (i,e): Beyaz
barishtor: Yeşillik Alan
basketbollist: Basketbolcu
bashkë: Birlikte
bashkëkohore: Çağdaş
bashkëthemeluesi: Ortak kurucu
bashkëveproj: Ortak hareket etmek
bashkoj: Birleştirmek
bateri: Bateria
bebe: Bebek
befasues: Şaşırtıcı
besë: Söz vermek
besim: İnanç
besoj: İnanmak
bëhem: Olmak
bëj: Yapmak
bërryl: Dirsek
bibliotekë: Kütüphane
bie: Düşmek
bijë: Erkek çocuk
bilardo: Bilardo
bimë: Bitki
bimësi: Ağaçlık alan, bitkilerin olduğu yer
bind: İkna etmek
bisedë: Sohbet
bisedoj: Sohbet etmek, konuşmak
bisht: Kuyruk
biznes: İş, ticaret
biznesmen: İş adamı
blej: Satın almak
bletë: Arı
boks: Boks
boksier: Boksör
bollshëm (i,e): Bereketli, bolca
botë: Dünya
botim: Yayın
bregdet: Sahil, deniz kıyısı
brenda: İçinde, içerde
bronz: Bronz
budalla: Aptal
bujar: Cömert

bujk: Çiftçi
bujqəsi: Tarım
bukë: Ekmek
bukur (i,e): Güzel
bulmet: Şarküteri
butë (i,e): Yumuşak
buzëkuq: Ruj

C

cak: Hedef
caktoj: Tespit etmek
celular: Cep telefonu
ceremoni: Kutlama
cili: Hangi
civilizim: Medeniyet
cjap: Keçi

Ç

çaj: Çay
çamçakëz: Sakız
çantë: Çanta
çdo: Her
çel: Açmak
çelës: Anahtar
çështje: Sorun
çfarë: Ne?
çmim: Fiyat
çmoj: Değer vermek
çmuar (i,e): Değerli
çokollatë: Çikolata
çuditshëm (i,e): Hayret verici, şaşırtıcı

D

dakord: Tamam
dal: Çıkmak
dallim: Fark
darkë: Akşam yemeği
dasmë: Düğün
dashamir: Hayırsever
dashuri: Aşk
dedikohem: Adanmak
degë: Bölüm
derë: Kapı
det: Deniz
detar: Denizci
deti i zi: Karadeniz
detyroj: Mecbur bırakmak
detyrueshëm (i,e): Mecburi

dëgjoj: Dinlemek
dëshirë: İstek, arzu
dëshiroj: Arzu etmek
dëshmorë: Şehit
di: Bilmek
diagnostikohem: Teşhis koymak
dialekt: Diyalekt
diçka: Herhangi bir şey
diell: Güneş
diferencë: Fark
dijetar: Bilgin
dikë: Herhangi birini
dikush: Herhangi biri
dimër: Kış
dinozaurë: Dinozor
diplomë: Diploma
diplomim: Mezun olma
diplomohem: Mezun olmak
disa: Birkaç
diskutim: Münakaşa, tartışma
dispozicion: Mevcut
distancë: Mesafe
ditë: Gün
ditëlindje: Doğum günü
dituri: Bilgelik
djali: Erkek çocuk
djathtak: Sağ elini kullanan, solak olmayan
djathtë (i,e): Sağ
dobi: Fayda
domethënë: Yani
domethënës: Çok önemli
domosdoshme: Gerekli
dorë: El
dorëshkrim: El yazısı
dorëzohem: El çekmek
drejtim: Yönelme
drejtuar (i,e): Yönlendirilen
dritare: Pencere
dritë: Işık
drithë: Tahıl
durim: Sabır
dush: Duş
dy: İki
dyshim: Şüphe
dytë (i,e): İkinci [2.]

Dh

dhe: Ve
dhelpe: Tilkı
dhembje: Ağrı
dheu: Toprak, ülke
dhëmbë: Dış
dhjetor: Aralık ayı
dhuratë: Hediye, armağan

E

ec: Yürümek
edukim: Eğitim
edhe: ve de
efektiv: Etkili
efektshëm (i,e): Etkili
eja: Gel
ekonomike: Ekonomik
ekran: Ekran
eksperiencë: Tecrübe
ekspozitë: Sergi
ekzistoj: Var olmak
elektronikë: Elektronik
emblema: Amblem
emër: İsim, ad
emocionale: Duygusal
emocionuar (i,e): Heyecanlı, duygulu
enciklopedi: Ansiklopedi
ende: Hala
energji: Enerji
energjike: Enerjik
enë: Bulaşık
entuziazëm: Coşku
etje: Susama
etnik: Etnik
evoluj: Şekil değiştirmek
Evropë: Avrupa

Ë

ëmbëlsirë: Tatlı
ëndërr: Rüya

F

faks: Faks
fakt: Gerçek, olgu
falë: Bağışlamak, armağan etmek
falsitet: Sahtekarlık
famë: Ün
familje: Aile

famshëm (i,e): Ünlü, tanınmış
faqe: Yüz, surat
farë: Çekirdek
famaci: Eczane
fat: Talih
favorshëm (i,e): Uygun, olumlu
fe: Din, inanç
femër: Bayan
femer: Çiftçilik
festë: Kutlama, şenlik, bayram
fetare: Dindar
fëmijë: Çocuk
figurë: Resim, karakter
film: Film
fillim: Başlama, başlangıç
fillimisht: Öncelikle
filloj: Başlamak
fisnik: Asil
fitoj: Kazanmak
fizikanë: Fizikçi
fizikë: Fizik
fjalë: Sözcük
flakë: Alev
flamur: Bayrak
fle: Uyumak
fletore: Defter
flori: Altın
flutur: Kelebek
fluturoj: Uçmak
folklor: Folklor
fonetikë: Ses bilim
forcë: Güç, kuvvet
formë: Şekil
fortë (i,e): Güçlü, sert
fosil: Fossil
foshnjë: Bebek
fotografi: Fotoğraf
fre: Dizgin
freski: Soğukluk
frikë: Korku
frutë: Meyve
fshat: Köy
fshatar: Köylü
fsheh: Saklamak, gizlemek
ftesë: Davet
ftohtë (i,e): Soğuk
ftuar (i,e): Davetli
fundjavë: Hafta sonu

fuqi: Güç, kuvvet
furrë: Fırın
fustan: Elbise
fut: Sokmak
futboll: Futbol
futbollist: Futbolcu
fytyrë: Surat

G

gadishull: Ada
garë: Yarış
gati: Hazır
gatem: Yemek yapmak
gatshtëm (i,e): Hazır
gaz: Sevinç
gazetë: Gazete
gegërisht: Geg diyalekti
gënjeshhtë: Yalancı
gërmoj: Kazmak
gërshërë: Makas
gëzim: Mutluluk
gëzohem: Memnun olmak
gisht: Parmak
gojë: Ağız
gotë: Bardak
gropë: Çukur
grua: Kadın
grup: Grup
grurë: Buğday
grusht: Yumuruk
gur: Taş
guxim: Cesaret

Gj

gjallë (i,e): Canlı
gjatë (i,e): Uzun
gjatësi: Uzunluk
gjej: Bulmak
gjellë: Yemek
gjendem: Olmak
gjendje: Olma
gjest: Mimik
gjeth: Yaprak
gjëra: Şeyler
gjigande: Dev
gjirafë: Zürafa
gjithashtu: Aynı şekilde
gjithçka: Her şey

gjithë: Tüm
gjithmonë: Her zaman
gjuhë: Dil
gjuhëtar: Dilci
gjumë: Uyku
gjurmë: İz
gjysmë: Yarım
gjysh: Dede
gjyshe: Nine

H

ha: Yemek yemek
habi: Şaşkınlık
habitem: Şaşırmak
hap: Açmak
hapur (i,e): Açık
hartë: Harita
harroj: Unutmak
hedh: Atmak
helmo: Zehirlemek
heq: Çıkarmak
herë: Kere, kez
herët (i,e): Erken
hero: Kahraman
heshtje: Sessizlik
hënë: Ay
hidhërim: Üzüntü
hidhur (i,e): Ekşi, acı
himni Kombëtar: Milli marş
histori: Tarih
historian: Tarihçi
hollë (i,e): İnce
homonim: Aynı yazılan farklı anlamlı kelimeler
huaj (i,e): Yabancı
humbur (i,e): Kayıp
hundë: Burun
hyj: Girmek
hyrje: Giriş

I

ide: Fikir
ideolog: İdeolog
imagjinoj: Hayal etmek
imazhe: Resim, görüntü
imitoj: Kopyalamak, taklit etmek
importim: İthalat
individë: Bireysel
industrial: Sanayi

informacion: Bilgi
informohen: Bilgilendirmek
inkurajoj: Cesaretlendirmek
instinktivisht: İçgüdüsel
institucion: Enstitü
integral: Kepekli yiyecek
intelektuale: Entelektüel
interesant: İlginç
interesim: İlgi
interesoheh: İlgiilenmek
investitor: Yatırımcı
investoj: Yatırım yapmak

J

janar: Ocak ayı
jap: Vermek
jashtë: Dışarı
jetike: Hayati
jetoj: Yaşamak
judo: Judo
jug: Güney
juglindore: Güney doğu

K

kafe: Kahve
kafene: Kahvehane
kafshë: Hayvan
kakao: Kakao
kala: Kale
kalb: Çürütmek
kalim: Geçit, geçme
kaloj: Geçmek
kalori: Kalori
kaltër (i,e): Mavi
kallëp: Kalıp
kalli: Koçan
kampion: Şampiyon
kanal: Kanal
kap: Kapmak, yakalamak
kapelë: Şapka
karamele: Karamel, şekerleme
karkalec: Karides
kartë Identiteti: Kimlik kartı
karrierë: Kariyer
kategori: Kategori
katër: Dört
katrorë: Kare
katund: Köy

keq (i,e): Kötü
këmbë: Ayak
këmbëngulje: Ayak direktmek, ısrar etmek
këmishë: Gömlek
kënaqësi: Memnuniyet
kënaqur (i,e): Memnun
këndshëm (i,e): Hoş
këngë: Şarkı
këngëtar: Şarkısı
këpucë: Ayakkabı
kërcej: Dans etmek
kilometër: Kilometre
kimi: Kimya
kinema: Sinema
kinematografi: Sinematografi
klasë: Sınıf
klasik: Klasik
klientë: Müşteri
klime: Hava
koha E Ardhshme: Gelecek zaman
koha E Kaluar: Geçmiş zaman
koha E Tashme: Geniş zaman
kohë: Zaman
kokë: Baş, kafa
kokëfortë: Kalın kafalı, anlayışsız
kokërr: Çekirdek
kombësi: Millet
kombëtar: Milli
kombinoj: Kombinasyon, birleştirme
kompani: Şirket
kompjuter: Bilgisayar
komunikim: İletişim
komunikoj: İletişim kurmak
komunitet: Toplum
konsideroheh: Değerlendirmek
konsumoj: Harcama yapmak
kontakt: Bağlantı
kontakttoj: Bağlantı kurmak
kontinent: Kıta
kontribuoj: Katkı sağlamak
korrik: Temmuz ayı
kos: Yoğurt
kotec: Kümes
krah: Kol, Kanat
krahasoj: Karşılaştırmak
krenar: Gururlu, onurlu
krijimtar: Yaratıcı
krijoj: Oluşturmak

krushk: Dünür
kryej: Tamamlamak
kryeqytet: Başkent
kryesisht: Başlıca
kryesore: Başlıca
kryetar: Başkan
kryetari: Başkanlık
kthehem: Geri dönmek
kthim: Dönüş
kthjelltësi: Berraklık
kudo: Her yerde
kufi: Sınır
kufizohem: Sınırlandırmak
kufje: Kulaklık
kujdestar: Nöbetçi
kujtim: Anı
kujtoj: Anmak, hatırlamak
kukull: Oyuncak bebek
kultivim: Yetiştirme
kulturë: Kültür
kulturor: Kültürel
kullotë: Otlak
kundër: Karşıt
kundroj: Tasarlamak
kuptim: Anlayış, anlama
kuptoj: Anlamak
kuq (i,e): Kırmızı
kur: Ne zaman
kureshtje: Merak
kurrë: Asla
kurriz: Sırt
kush: Kim
kuvend: Meclis
kuzhinë: Mutfak

L

lagësht (i,e): Nemli, rutubetli
lajm: Haber
lajmëroj: Haber vermek
lamtumirë: Hoşçakal
laps: Kalem
largohe: Uzaklaşmak
lartë (i,e): Yüksek
lartësi: Yükseklik
lartësoj: Yükseltmek
lashtë (i,e): Eski
ledhatoj: Okşamak
legjendë: Efsane

lehte (i,e): Hafif
leje: İzin
lejim: İzin verme
lejoj: İzin vermek
letër: Kağıt
letërsi: Edebiyat
lexim: Okuma
lexoj: Okumak
lë: Bırakmak
lëvdjoj: Övmek
lëvizshëm (i,e): Hareketli
lëvrim: Tarla sürme
lidh: Bağlamak
lidhëse: Bağlaç
lidhje: Bağ
ligj: Kanun, Yasa
limonë: Limon
lind: Doğmak
lis: Meşe
listë: Liste
literaturë: Literatür
livadh: Çayır
lodër: Oyuncak
lodh: Yorulmak
lodhur (i,e): Yorgun
lojë: Oyun
lojtar: Oyuncu
lot: Gözyaşı
loz: Oynamak
luftë: Savaş
luks: Lüks
lule: Çiçek
luleshtrydhe: Çilek
lum: Nehir
lumtur (i,e): Mutlu
lumturi: Mutluluk
lutje: Dua
lyhem: Boyanmak
lyp: Dilenmek

LL

llogari: Hesap
lloj: Çeşit, Tür

M

mace: Kedi
madh (i,e): Büyük
majmun: Maymun

majtake: Solak
majtë (i,e): Sol
makinë: Araba
mal: Dağ
malor: Dağlık alan
mango: Mango
martohem: Evlenmek
marr Pjesë: Yer almak
marr: Almak
marrëveshje: Anlaşma
mat: Ölçmek
material: Gereç
mbahem: Tutulmak
mbaj: Tutmak
mbarësi: Refah
mbaroj: Bitirmek
mbështes: Yaslamak, dayanmak
mbështetje: Yaslama, dayanma
mbi: Üzerinde
mbizotërim: Üstünlük
mbledh: Toplamak
mbret: Kral
mbretëri: Krallık
mbrohem: Korunmak
mburr: Övmek, övünmek
mbush: Doldurmak
mbyll: Kapamak
medalje: Madalya
media sociale: Sosyal medya
media: Basın
megjithatë: Buna rağmen
mençur (i,e): Akıllı
mend: Akıl
mendim: Düşünce
mendimtar: Düşünür
mendje: Akıl
mendoj: Düşünmek
menjëherë: Hemen
merak: Merak
meritë: Hak
meritoj: Hak Etmek
mesazh: Mesaj
metal: Metal
metod: Yöntem
mëmëdhe: Ana vatan
mëngjes: Sabah
mënyrë: Durum
mërkurë: Çarşamba günü

mërzi: Sikkınlık
mësim: Ders
mësipërm: Üstteki
mësoj: Öğrenmek
mësues: Öğretmen
mësysh: Nazar Etmek
mëvonshëm (i,e): Daha sonraki
mi: Fare
midis: Arasında
mik: Dost
mikpritës: Misafirperver
mikpritja: Misafirperverlik
mikrofon: Mikrofon
milion: Milyon
mirë (i,e): İyi
mirupafshim: Güle güle
misër: Mısır
mishngrënëse: Etobur
mjaft: Yeterli
mjaftueshëm (i,e): Yeterli
mjaltë: Bal
mjek: Doktor
mjekër: Sakal
mjekësore: Tibbi
mjet: Araç gereç
model: Model
modest: Mütevazı
mollë: Elma
moment: An
monedhë: Bozuk para
monument: Heykel
morale: Ahlaki
morfologji: Morfoloji
moshatarë: Yaşlı
moshë: Yaş
mot: Yıl
motër: Abla, kız kardeş
motivohem: Motive olmak
motivoj: Motive olma
motor: Motor
mplak: Aşırı yaşlanmak
mprehtë (i,e): Keskin
mungesë: Eksiklik
mungoj: Eksik olmak
mur: Duvar
muskul: Kas
mustaqe: Bıyık
muze: Müze

muzikë: Müzik
mysafir: Misafir
Mysliman: Müslüman

N

namaz: Namaz
natyrë: Doğa
natyror: Doğal
ndahem: Ayrılmak
ndaj: Ayırmak
ndal: Durmak
ndalem: Durma
ndaluar (i,e): Yasaklanmış
ndarje: Ayrılık
ndeshje: Maç
ndërkombëtarë: Uluslararası
ndërsa: İse
ndërtesë: Bina
ndërtohet: İnşa etmek
ndihem: Hissetmek
ndihmoj: Yardım etmek
ndikim: Etkileşim
ndikoj: Etkilenmek
ndjej: Hissetmek
ndjek: Takip etmek
ndjenjë: His
ndodh: Bir şeyin olması
ndonjëherë: Bazen
ndryshëm (i,e): Değişik
ndryshim: Değişim
ndryshoj: Değişmek
negativë: Olumsuz
nevojë: İhtiyaç
Nevojshëm (i,e): Gerekli
në rregull: Tamam
nën: Alt
nënë: Anne
nënkuptoj: Anlam çıkartma
nëntor: Kasım ayı
nëpër: İçinden
nëse: Eğer
nganjëherë: Bazen
ngrihem: Kalkmak
ngrohtë (i,e): Sıcak
ngushtë (i,e): Dar
ngjall: Canlandırmak
ngjitem: Tırmanmak
ngjyre: Renk

normë: Norm
notoj: Yüzmek
novelist: Yazar
numër: Sayı
nuse: Gelin
nxehtë (i,e): Sıcak
nxirr: Kararmış

NJ

njerëzim: İnsanlık
njeri: İnsan
një: Bir
njëherë: Bir defa
njëjtë (i,e): Aynısı
njëkohësisht: Aynı zamanda
njëri-tjetri: Birbiri
njësoj: Aynı
njëvjeçar: Bir yıllık
njihem: Tanınmak
njohur (i,e): Tanınmış
njohuri: Tanınmışlık, bilinirlik

O

oborr: Bahçe
oficer: Subay
ofrim: Öneri
ofroj: Önermek
oksigjen: Oksijen
oktapod: Ahtapot
olimpik: Olimpik
operë: Opera
orë: Saat
organizatë: Kuruluş
organizohem: Organize etmek
origjinë: Köken
osë: Ve ya

P

paguaj: Ödemek
pajisje: Donanımlı
pak: Az
pakësuar (i,e): Azalmış
paleontolog: Taşıl bilimci
palodhur (i,e): Yorulmayan
palosur (i,e): Katlanmış
pallat: Bina, apartman
pamundur (i,e): Halsiz, imkansız
pantallona: Pantolon

paqe: Barış
para: Ön
para: Para
parafjalë: Zarf
paragykim: Ön yargı
parë (i,e): Birinci (1.)
pasion: Hırs
pastroj: Temizlemek
pasur (i,e): Zengin
pasuri: Zenginlik
pasuroj: Zenginleşmek
pashëm (i,e): Yakışıklı
pashmangshmëri: Kaçınılmazlık
patëllxhanë: Patlıcan
patjetër: Tabii ki
pavarësi: Özgürlük
pavdekshëm (i,e): Ölümsüz
pazar: Pazar
pemë: Ağaç
pension: Emeklilik
perëndim: Doğu
performancë: Performans
perime: Sebze
periodik: Periyodik, süreli
periudhë: Süre
persisht: Farsça
person: Birey, kişi
pesë: Beş
peshëngritje: Halter
peshk: Balık
pëlqej: Beğenmek
pëllëmbë: Ayuç içi
për herë të parë: İlk defa
për Shëmbull: Örneğin
për: İçin
përafërsisht: Yaklaşık olarak
përbashkët (i,e): Ortak
përbëj: Oluşturmak
përbërës: Bileşen
përbri: Yanında
përcaktim: Belirlemek
përçarje: Ayırım
përdor: Kullanmak
përfshij: İçermek
përfundim: Sonuç
përgatit: Hazırlamak
përgjatë: Boyunca
përgjigje: Cevap

përgjigjem: Cevaplamak
përgjithësi: Genel olarak
përgjithshëm (i,e): Genel
përjashta: Dışarıda
përjashtohem: Uzaklaştırılmak, dışlanmak
përjetoj: Yeniden yaşamak
përkufizim: Sınırlandırılmak
përkul: Eğilmek
përkulur (i,e): Eğik
përkushtim: Adanmak
përmbaj: İçermek
përmend: Anmak, tekrarlamak
përmes: Arasında
përnjëherë: Aniden
përpara: Önde
përparim: İlerleme, gelişme
përparoj: İlerlemek, gelişmek
përpkje: Uğraş
përpunoj: Yenilemek
përputh: Bağdaştırmak
përqafoj: Sarılmak
përqindje: Yüzde
përshtëndetje: Merhaba
përshtatshëm (i,e): Uygun
përtypje: Çiğnemek
përveç: Hariç
përvetësoj: Benimsemek
përvojë: Tecrübe
pështymë: Tükürük
pi: İçmek
picë: Pizza
pije: İçecek
pikëpamjë: Bir açıdan bakmak
piktor: Ressam
pikturë: Resim
pikturoj: Resim çizmek
pishinë: Havuz
pjek: Pişirmek
pjerrët (i,e): Eğik
pjesë: Parça, bölüm
planifikoj: Planlamak
plas: Patlamak
platformë: Platform
plot: Dolu
plotësisht: Tamamen
pohim: Onaylamak, kabul etmek
popullsi: Topluluk
por: Ama

portativ: Seyyar
postë: Posta
poshtë: Aşağı
pothuajse: Neredeyse
pozitivë: Pozitif, olumlu
prandaj: Bu yüzden
pranë: Yanında
pranoj: Kabul etmek
prapë: Tekrar
preferencë: Tercih
prehër: Kucak
prekje: Dokunuş
premtë: Cuma
premtim: Söz vermek
premtoj: Söz vermek
pres: Beklemek
prezantohet: Tanıtmak
prill: Nisan ayı
primitiv: İlkel
prish: Bozmak
problem: Problem, sorun
produktiv: Üretken
prodhim: Üretim
prodhøj: Üretmek
profesion: Meslek
profesionist: Usta
projekt: Proje
provim: Sınav, deneme
pse: Neden
publicist: Yazar
publikim: Yayın
punë: İş
punëtor: İşçi
punoj: Çalışmak
punonjë: Eleman, işçi
pus: Kuyu
pushim: Ara, mola, tatil
puth: Öpmek
pyes: Sormak
pyetje: Soru

Q

qafë: Ense
qaj: Ağlamak
qarku: İlçe
qartësi: Aciklik, netlik
qebap: Kebap

qen: Köpek
qendër: Merkez
qengj: Kuzu
qesh: Gülmek
qeveri: Hükümet
qëllim: Amaç, gaye
qëndis: Nakış, dikiş
qëndroj: Bulunmak, durmak
qiell: Güneş
qime: Kıl, tüy
qind: Yüz {100}
qortoj: Azarlamak
qyp: Küp
qytetar: Vatandaş

R

racë: Irk
radio: Radyo
rajon: Bölge
rajonat: Bölgesel
rastësi: Tesadüf
realizoj: Gerçekleştirmek
refuzoj: Reddetmek
regjisor: Yönetmen
regjistroj: Kayıt etmek
reklamë: Reklam
rekord: Rekor
respekt: Saygı
respektuj: Saygı duymak
restorant: Restoran
revistë: Dergi
rezultat: Sonuç
rëndë (i,e): Ağır
rëndësishëm (i,e): Önemli
rërë: Kum
ri (i,e): Genç
ri (i,e): Yeni
rini: Gençlik
rol: Rol
roman: Roman
ruaj: Korumak
ruajtje: Koruma
rurale: Kırsal

RR

rrafshoj: Dizmek
rregullim: Düzeltme
rreth e rrotull: Civar

rreth: Etraf
rrethim: Kuşatma
rreze: Işın
rrënjë: Kök
rri: Durmak
rritem: Büyüme
rritje: Büyümek
rrobë: Giysi
rrogë: Maaş
rrugë: Yol
rrugicë: Patika
rumbullakët: Yuvarlak

S

sa: Kaç, ne kadar
sallata: Salata
sallë: Salon, alan
sekondë: Saniye
sektorë: Sektör
semantika: Sözcük bilim
send: Eşya
sepse: Çünkü
së Shpejti: Bir an önce, çok çabuk
sëmundje: Hastalık
sëmur: Hasta
si: Nasıl
siç: Gibi
sidoqoftë: Buna rağmen
sigurisht: Tabii ki
sikur: Sanki
sjell: Getirmek
simbolizoj: Sembolize etmek
sinonim: Eş anlam
sinjal: Sinyal
sipas: -e göre, tarafından
sipërfaqe: Yüzey
sistem: Sistem
sjellje: Davranış
skalitje: Sanatta oyma işi
skenë: Sahne
sociale: Sosyal
sot: Bugün
sotëm (i,e): Bugünkü
specialitete: Spesiyalite
sportist: Sporcu
sportive: Spor
standarde: Standart
statuja: Statü

tërholluar: Aşırı incelmış
Stërvitje: Antrenman
stilolaps: Tükenmez kalem
strategji: Strateji
studim: Çalışmak
studioj: Çalışma
sukses: Başarı
sukseshëm (i,e): Başarılı
sulmoj: Saldırma
supermarket: Süpermarket
surprizë: Sürpriz
sy: Göz
syze dielli: Güneş gözlüğü

SH

shalë: Eyer
shall: Şal
shekull: Yüzyıl
shenjë: İşaret
sheqer: Şeker
shesh: Yer, zemin
shëmtuar (i,e): Çirkin
shëndet: Sağlık, çok yaşalı
shënim: Not etme
shërbej: Hizmet etme
shërbim: Hizmet
shërues: İyileştirici
shfaq: Göstermek
shi: Yağmur
shije: Tat
shikoj: Bakmak
shishe: Şişe
shit: Satmak
shkaktaj: Sebep olmak
shkathtësi: Atiklik
shkencë: Bilim
shkencëtar: Bilim adamı
shkëlqej: Parlamak
shkëpus: Koparmak
shkoj: Gitmek
shkollë: Okul
shkop: Sopa
skresë: Yazılı bir şey
shkrim: Yazı
shkrimtar: Yazar
shkruaj: Yazmak
shkurt (i,e): Kısaca
shkurtër (i,e): Kısa

shkurtohem: Kısalmak
shkurtoj: Kısaltmak
shmang: Uzaklaştırmak
shokë: Arkadaş (erkek)
shoqëri: Topluluk, arkadaşlık
shoqërohem: Eşlik etmek
shpallur: İlan edilmiş
shpatull: Omuz
shpejtë (i,e): Çabuk
shpellë: Mağara
shpesh: Sık sık
shpëmdaj: Dağıtmak
shpërngulem: Yer değiştirmek
shpik: İcat etmek
shpikës: Mucit
shpirt: Can, yürek, ruh
shpirtërore: Manevi
shpreh: İfade etmek, söylemek
shprehi: İfade, söylem
shpresë: Umut
shpresoj: Umut etmek
shqetësim: Huzursuzlaştırmak, rahatsız etmek
shqiptar: Arnavut
shtet: Devlet
shtëpi: Ev
shtoj: Ekleme
shtrat: Yatak
shtrenjtë (i,e): Pahalı
shtrydh: Sıkmak
shtunë: Cumartesi
shtypur (i,e): Ezilmiş
shuaj: Yok etmek
shumë: Çok
shumëllojshëm (i,e): Çok çeşitli

T

Tabletë: Tablet
Tablo: Tablo
Takim: Görüşme
Takohem: Görüşmek
Taksi: Taksi
Talentuar (i,e): Yetenekli
Tanishëm (i,e): Şu anlık, şimdilik
Tava: Tava
Teatër: Tiyatro
Teatrale: Dramatik
Teknologji: Teknoloji
Teknologjike: Teknolojik

tekst: Metin
telefon: Telefon
televizor: Televizyon
temperaturë: Hava sıcaklığı, ateş (vücut sıcaklığı)
tenis: Tenis
teori: Teori, kuram
teorik: Kuramsal
teproj: Abartmak
term: Terim
territor: Bölge
teshtij: Hapşurmak
tetor: Ekim ayı
tërheq: Çekmek
tifozë: Taraftar
titull: Başlık
tjetër: Başka
tokë: Toprak, yeryüzü, dünya
tortë: Yaş pasta
toskërisht: Tosk diyalekti
total: Total
tradicionale: Geleneksel
traditë: Gelenek
transmetim: İletmek, ulaştırmak
transport: Taşımak, nakletmek
trashë (i,e): Kalın
trashëgim: Miras
tregoj: Göstermek, anlatmak
tregtar: Tüccar
tretë (i,e): Üçüçü (3.)
trëndafil: Gül
trim: Yiğit
trokas: Tıklamak
tru: Beyin
trung: Kütük
trup: Vucut
tund: Sallamak
turizëm: Turizm
Turqisht: Türkçe
turshi: Turşu

Th

thatë (i,e): Kuru
thelbësor: Temel, merkezi
thellë (i,e): derin
them: Söylemek
themelor: Temel
themelues: Kurucu
thesar: Hazine

thënie: Söylem
thirr: Çağırarak
thirrje: Çağrı
thjeshtë (i,e): Kolay, basit

U

udhëtim: Yolculuk
udhëzim: Yönlendirme
ujë: Su
ul: Oturmak
ulli: Zeytin
unë: Ben
urë: Köprü
uri: Açlık
uroj: Ummak, dilemek
urrej: Nefret etmek
ushqehem: Beslenmek
ushqim: Yemek

V

vaji Ulliri: Zeytin yağı
valle: Halay
vallëzim: Dans
vanilje: Vanilya
varësi: Bağlı olarak
varfër (i,e): Fakir
variacion: Varyasyon
varr: Mezar
vashë: Kız
vazhdimisht: Devamlı
vazhdoj: Devam etmek
vdekje: Ölüm
vdes: Ölmek
veçantë (i,e): Özel
veçori: Özellik
vegjetarianë: Vejeterjan
vend: Yer
vendlindja: Doğum yeri
vendos: Karar vermek
vendosshmëri: Kararlılık
vendosur (i,e): Kararlı
vepër: Eser
veprimtari: Faaliyet
veproj: Davranmak, hareket etmek
verdhë (i,e): Sarı
verë: Yaz mevsimi
veri: Kuzey
verilindje: Kuzeybatı

veriperëndim: Kuzeydoğu
vesh: Giymek
vesh: Kulak
vetë: Kişi
vetëm: Yalnız, tek
vetjak: Kişisel
vetvetes: Kendi kendine
vezë: Yumurta
vë: Koymak
vëllai: Erkek kardeş, abi
vëllim: Cilt (kitap)
vëmendje: Dikkat
vërtetë (i,e): Gerçek
vështirë (i,e): Zor
vështirësi: Zorluk
vështrim: Bakma, izleme
vëzhgoj: Gözlemlemek
vij: Gelmek
vijë: Çizgi
violinë: Violin
virtyt: Fazilet
vit: Sene, yıl
viti i ri: Yeni yıl
vizatoj: Resim yapmak
vizitorë: Ziyaretçi
vjell: Kusmak
vjet: Yaş
vjetër (i,e): Eski
vjollcë: Menekşe
vlefshëm (i,e): Değerli
vlerë: Değer
vlerësohem: Değerlendirilmek
vocërr (i,e): Çok küçük
vogël (i,e): Küçük
vogli (i,e): Ufak
vonë (i,e): Geç
vrapoj: Koşmak
vras: Öldürmek, vurmak
vullnet: Gönüllülük

Xh

xhami: Cami
xheloz: Kiskançlık
xhep: Cep

Y

yll: Yıldız
yndyrë: Hayvansal yağ

Z

- zakon:** Örf, âdet
zakonisht: Geleneksel
zbatim: Uygulama
zbathur (i,e): Yalın ayak
zbritje: İndirim, iniş
zbukurim: Süslemek, güzelleştirmek
zbuloj: Keşfetmek
zell: Azim
zellshëm (i,e): Azimli
zemër: Kalp, yürek
zemërim: Üzülme
zë: Ses
zë: Yakalamak, tutmak
zënë (i,e): Meşgul
zgjedh: Seçmek
zgjdh: Çözmek
zgjdhje: Çözüm
zgjim: Uyanma
zi (i,e): Siyah
zile: Zil
zjarrtë (i,e): Ateşli
zonjë: Hanım
zotëroj: Sahip olmak
zoti: Bey

ZH

- zhdukje:** Ortadan kaybolma
zhvillim: Gelişme
zhvillohem: Gelişmek
zhvilloj: Geliştirmek
zhytëse: Deniz altı

VIZUALE

FRASHËRI, S. (2002). Dheu është flori. Tiran: Drier Yayınevi.

ISAACSON, W. (2012). Steve Jobs, Tiran: Pegi Yayınları.

KADARE, I. (2004). Kush e Solli Doruntinën. Tiran: Onufri Yayınevi.

KARANFILI, I. ve OSMANI, Z. (2010). Gjuha Shqipe dhe Leximi për klasën VIII. Üsküp: Grafiçki Center Yayınevi, s. 52.

MEB. (2017). Ortaokul ve İmam Hatip Ortaokulu Yaşayan Diller ve Lehçeler Dersi (Arnavutça; 5, 6, 7 ve 8. Sınıflar) Öğretim Programı. Ankara: MEB Yayınları.

PETRO, R. vd. (2016). Gjuha Shqipe 2. Tiran: Albas Yayınevi.

WHEELER, J. A. (1980). Albert Einstein 1879-1955. Washington: National Academy of Sciences.

BURIMI I INTERNETIT-REFERENCAT VIZUALE

